

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarëve profesionistë, Suzana Çerkini, kryetare, Afërdita Bytyqi dhe Arben Hoti, anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. H., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPRK, V. B. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar. 2.4 të KPRK, i akuzuari A. M., për shkak të veprës penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK, si dhe i akuzuari F. F. për shkak të veprës penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut, tani Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr. 95-7/2012 të datës 20.04.2012, pas shqyrtimit kryesor, në procedurë të rigjykimit, të hapur për publikun, të përfunduar me datë 13.12.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari, përfaqësuesit të palës së dëmtuar me autorizim, Sh. H., të akuzuarve A. H. me mbrojtësin me autorizim av. T. B., V. B. me mbrojtësin me autorizim av. D. R., F. F. me mbrojtësin me autorizim av. O. H. dhe A. M. me mbrojtësit me autorizim av. A. K. dhe G. V., me datë 15.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit

1. **A. H.**, nga i ati I. dhe nëna D., e vajzërisë B., i lindur me datë *data e lindjes...* në Gj. tani jeton në P., me vendbanim në rrugën "...", nr...., ka të kryer fakultetin juridik, i martuar babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. **V. B.**, nga i ati F. dhe nëna M., e vajzërisë Sh., i lindur me datë *data e lindjes...* në M., tani jeton në P., me vendbanim në lagjen "...", U-.,hyr. . nr., ka të kryer fakultetin e arteve, i martuar babë i dy fëmijëve, me profesion kompozitor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
3. **F. F.**, nga i ati N. dhe nëna M., e vajzërisë M., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin Zh. i E., Komuna M., tani jeton në P., me vendbanim në rrugëm "...", nr. ..., ka të kryer magjistraturën për producent filmi, i martuar babë i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
4. **A. M.**, i biri i A. dhe nënës L., e vajzërisë Zh., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Gj., tani me vendbanim në P. rr."...", nr.../..., ka të kryer Akademinë e Arteve-dega aktrimi, i pa martuar, me profesion aktor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTORË

Sepse, I akuzuari A. H.,

Si person zyrtar, ministër në MKRS, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë “M. F.” ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe ka tejkaluar autorizimet ashtu që, në kundërshtim me Ligjin për Kinematografinë nr.2004-22 dhe Ligjin mbi Prokurimin Publik nr.2003/17, pa shpallur fare konkurs për projekte filmike, me datë 30.01.2007 ka lidhur kontratën me pronarin e kompanisë së përmendur A. M., për subvencionimin e filmit të metrazhit të gjatë “Mysafir në Sofër”, në shumë prej 350.000 euro, e cila nuk është protokolluar në librat e ministrisë, duke i siguruar në këtë mënyrë kompanisë përfitim të kundërligjshëm, në dëm të buxhetit të MKRS,

- me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me par. 2 nënpar. 2.4 të KPRK,

I akuzuari V. B.,

Si person zyrtar, ministër në MKRS, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për kompaninë “M. F.”, ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe ka tejkaluar autorizimet ashtu që, me datë 19.09.2008 edhe pse ka pasur dijeni se kontrata e datës 30.01.2007 që kishte lidhur ministri i mëparshëm i MKRS, i pandehuri A. H., ishte e kundërligjshme, ka lidhur aneks kontratën me pronarin e kompanisë së përmendur A. M., në bazë të së cilës ka marrë vendim për transferimin e mjeteve nga vija e investimeve kapitale në atë të subvencioneve dhe, në bazë të saj me 16.10.2008 nga buxheti i MKRS i janë paguan kompanisë 100.000 euro, duke i siguruar asaj përfitim të kundërligjshëm dhe njëkohësisht duke e dëmtuar buxhetin e MKRS për këtë shumë,

- me çka ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me par. 2 nënpar. 2.4 të KPRK,

I akuzuari F. F.,

Si person përgjegjës pronar i kompanisë Sh.p.k.“C. P.”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka prezantuar në MKRS llogari të rreme si shpenzime për xhirimin e filmit “P. C.”, që kurrë nuk është realizuar, ashtu që me datë 27.02.2006, ka lidhur kontratë për subvencionimin e filmit të metrazhit të gjatë, në shumë prej 220.000 euro dhe nga buxheti i MKRS me datë 19.04.2006, i janë paguar 90.000 euro, si dhe me datën 20.04.2006, i janë paguar 98.000 euro, duke përfituar shumen e të hollave prej 188.000 euro, për gjirimin e filmit të lartshënuar, i cili nuk është realizuar,

-me çka ka kryer veprën penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK,

I akuzuari A. M.,

Si person përgjegjës, pronar i kompanisë “M. F.”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ka prezantuar në MKRS llogari të rreme si shpenzime për gjirimin e filmit “Mysafir në sofër” që kurrë nuk është realizuar, në atë mënyrë që me datën 30.01.2007, ka lidhur kontratë me MKRS, për subvencionimin e këtij filmi të metrazhit të gjatë, në shumën prej 350.000 euro dhe, me datën 19.09.2008 ka lidhur aneks kontratë për realizimin e këtij filmi, ashtu që me datën 16.10.2008, MKRS ka paguar në xhirollogarin e kompanisë “M. F.”, shumën prej 100.000 euro, ashtu që në këtë mënyrë ka përfituar shumën prej 100.000 euro,

- me çka ka kryer veprën penale Mashtrimi në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 11,15,34,41,42,43,44,45,64,66 par.2 të KPK dhe neneve 365,366, 406 të KPP, i gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të secilit të akuzuar i përcakton:

1. A. H., dënim me burgim në kohëzgjatje prej prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **2 (dy) vjetësh**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen veprë të re penale,
2. V. B., dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **2 (dy) vjetësh**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen veprë të re penale,
3. F. F., dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **2 (dy) vjetësh**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen veprë të re penale,
4. A. M., dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **2 (dy) vjetësh**, nëse gjatë kësaj kohe nuk kryen veprë të re penale,

Të akuzuarit në mënyrë solidare obligohen t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor secili në shumë prej nga **100 euro** (njëqind) euro.

Obligohen të akuzuarit A. M. dhe F. F. që të dëmtuarës, MKRS, t’ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe atë, i akuzuari A. M. në shumë prej 100.000 euro, kurse i akuzuari F. F., në shumë prej 188.000 euro, në afat jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- **Historiku i procedurës**

Prokuroria Publike e Qarkut tani Themelore ne Prishtinë-Departamenti per Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.nr.95-7/2012 të datës 20.04.2016, kundër A. H. për dy vepra penale Shpërdorim i pozits zyrtare ose i autorizimeve nga neni 339 par 3 lidhur me par 1 të KPK, V. B. për shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimeve nga neni 339 par 3 lidhur me par 1 të KPK, F. F. dhe A. M. secili per vepren penale Mashtrim në detyrë nga neni 341 par.3 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë Aktgjykimin PKR.nr.431/13 të datës 01.12.2015, i cili është ankimuar nga palët, andaj Gjykata e Apelit të Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, me Aktvendimin PAKR.nr.256/2016 të datës 02.06.2016, ka anuluar aktgjykimin e lartshënuar dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim në shkallë të parë, po ashtu njëherit ka ndryshuar aktgjykimin në drejtim te refuzimit të aktakuzës ndaj të akuzuarit A. H., për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 nënpar 2 pika. 2.4 te KPRK, të përshkruar në dispozitivin I të aktakuzës, për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale. Më tutje nga Gjykata e Apelit është rekomanduar që në procedurë të rigjykimit, në evitim te shkeljeve te gjetura, edhe njëherë te nxirren provat veç e veç, të sqarohet nëse çështja në gjykim është e natyrës juridiko-penale, juridiko-civile apo ekonomike, të bëhet vlerësimi i ekspertizës financiare, vlerësimi i aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike te Qarkut Prishtinë C.nr.13/2011 i datës 28.02.2012 dhe që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen ish kryeministrat B. K. dhe A. C..

Gjykata e shkallës së parë, në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes, mbajti shqyrtim të ri gjyqësor, në të cilin prezantuan prokurori i shtetit, të akuzuarit të shoqëruar me mbrojtësit e angazhuar, av. T. B., av. D. R., av. A. K., av.G. V. e av. O. H. si edhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, Sh. H..

Prokurori i shtetit i paraqiti gjykatës dhe të akuzuarve F. F. dhe A. M., kopje të dispozitivit të precizuar të aktakuzës që ka të bëjë me këta dy të akuzuar, në të cilat janë përshkruar koha dhe mënyra e veprimit të të akuzuarve, ndërsa kuaifikimi ligjor ka mbetur i njëjtë, ashtu siç është paraqitur në versionin e tanishëm të këtij aktgjykimi.

Gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, edhe në procedurë të rigjykimit, katër të akuzuarit kanë mohuar fajsinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, ndërsa prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti pranë aktakuzës së precizuar, që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, duke përjashtuar pikën 1 të dispozitivit të aktkuzës, e cila ka të bëjë me veprën penale që është parashkruar dhe tanimë është bërë e formës së prerë, ndërsa mrojtësit e të akuzuarve propozuan që, në mungesë të provave, për të mbrojturit e tyre gjykata të merr aktgjykim lirues.

- **Mbrojtja e të akuzuarit A. H.**

I akuzuari A. H., në mbrojtjen e vet ka deklaruar se mbetet pranë deklaramit të dhënë në shqyrtim të mëparshëm gjyqësor, në të cilin ka deklaruar se si ministrër i MRKS ka qenë nga dhjetori 2004

deri në janar 2008, se Ligji për Kinematografi ka qenë i miratuar, por QKK ka filluar punën në fund të mandatit të tij. I akuzuari spjeron se ndarja e buxhetit në MRKS është bërë në bazë të politikave programore, ndërsa në atë kohë nga përfaqësuesi i administratës së Unmik-ut është dashur të aprovohet çdo vendim mbi shumën prej pesë mijë euro. Pranon se në zyë ka pritur producentët e projektit filmik “Mysafir në Sofër” edhe i ka përkrahur në parim, por nuk ka pasur buxhet të mjaftuar, andaj projekti është shtyrë për një kohë, pastaj thekson se edhe Qeveria e Kosovës e ka përkrah këtë projekt filmik dhe ka marrë vendim i cili ka qenë obligativ të respektohet, mirëpo në mungesë të mjeteve financiare projekti ka ngecur deri në vitin 2008, kur edhe sërish projekti është përkrahur dhe është marrë vendimi i dytë nga kryeministri A. Ç., andaj siç thekson vetëm e ka implementuar vendimin e Qeverisë. Në vazhdim thekson se detyrimisht kontrata është dashur të protokolohej pasi mbanë vulën e Unmik-ut, se subvencionet janë ndarë pa prokurim siç ndodhë edhe sot, sepse ka pasur raste që brenda natës janë kërkuar për qëllime sporti 20 apo 30 mijë euro dhe nuk ka pasur kohë për tenderime, gjatë mandatit të tij thotë se nuk ka pasur konkurse. Pranon se ka autorizuar drejtoreshën A. T. në çfarëdo qoftë mënyre, dhe se kjo ka qenë kompetencë e tij të autorizojë dikend sipas vullnetit të tij si ministër, pranon se gjatë mandatit të tij ka pasur zëvendësministër e kjo ka qenë A. K. dhe një person i nacionalitetit turk me emrin E., ndërsa drejtori i parë i QKK ka qenë Z. H., thekson se nuk ka qenë detyrë e ministrit me e shqyrtua gjithë dokumentacionin e projektit, nuk i kujtohet se ka kërkuar me shkrim shqyrtimin e kontratës kur kooproductent kanë qenë Sh. dhe I., pohon se ka pranuar shkresën nga K. B. dhe K. G., nuk e beson se ka mund të kalojë ndonjë projekt pa dokumentacionin përkatës, pranon se nuk ka marrë vendim për anulimin e kontratës.

Ndërsa në prokurori me datë 02.04.2012 i akuzuari A. ka deklaruar se pas lidhjes së kontratës me M. F., në disa raste të njëjtit i është bërë pagesa në shumë prej 14-15 mijë euro, por kur ka parë se koproducentit I. i është blerë bileta në shumë prej 5000 euro, ka vendosur të mos lejojë mëtej pagesa tjera që i kërkonte A. M. për xhirimin e filmit, për çka A. M. publikisht ka reaguuar, andaj thotë se ka ndërprerë kontratën për shkak se A. M. nuk i ka përmbyll avanset. Pranon se nuk ka pasur bord të formuar për vlerësimin e projektit filmik, se në mungesë të QKK, nuk është shpallë konkurs, ndërsa si ministër thotë se ka pasur kompetencë me aprovu ndonjë projekt filmik në bazë të sygjerrimeve dhe rekomandimeve të stafit përkatës, thotë se me siguri projekti “Mysafir në Sofër” është dorëzuar në Sektorin për Kinematografi e pastaj përmes Departamentit për Kulturë ka ardhë në zyrën e Sekretarit permanent dhe te ministri.

Në vazhdim, në shqyrtim të tanishëm gjyqësor, thekson se nuk i kujtohet nëse ka formuar ndonjë bord për vlerësim të projekteve filmike që janë objekt i akuzës, më pas thotë ndoshta ka formu sipas nevojës borde ad hoc por nuk i kujtohet. Sa për projektin “Mysafir në Sofër” thekson se e ka ndërpre çdo veprimtari me drejtorin e projektit për shkak të mospërmbushjes së obligimit ndaj ministrisë, por nuk i kujtohet në çfarë forme. Sa i përket mospagesës së kështit të parë të precizuar si në kontratën e datës 30.01.2007 me “M. F.” thekson se nuk ka pasur mjete buxhetore, meqë nga data 17 nëntor e deri më 31 janar të vitit vijues nuk ka mundur të bëjë asnjë transfer, për shkak se është bërë përmbyllja e thesarit.

- **Mbrojtja e të akzuarit V. B.**

Derisa në shqyrtimin gjyqësor të mëparshëm shfrytëzon të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje, në shqyrtimin gjyqësor në këtë fazë të rigjykimit, i njëjti në mbrojtjen e vet thekson se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datë 28.03.2012, në të cilën ka deklaruar se si ministër i MKRS ka qenë nga prilli i vitit 2008 deri më prill të vitit 2010, thekson se ka kërkuar skenarin e filmit “Mysafir në sofër” dhe të njëjtin e ka lexuar, thotë se është i sigurt që A. M. ka siguruar edhe planifikimin financiar të kostos së filmit që ka qenë diku pesë milion euro, i cili me siguri ka qenë i protokoluar në MKRS më pas ka vlerësuar se kontrata e datës 30.01.2007 ishte obliguese për të, ka marrë vendim për transfer të brendshëm të mjeteve financiare dhe pasi ka vërejtur se kontrata ka mangësi dhe nuk përcaktonte obligimet e kontraktuesit “M. F.” për interes të MKRKS ka nxjerrë Ankes kontratë në vitin 2008, ashtu që në emër të kështit të parë ka bërë pagesën e 100 mijë eurove, ndërsa në fund të vitit 2009 ka kërkuar raporte për përmbylljen e avanseve për të gjitha projektet, nuk ka pa personalisht raport të prezantuar nga “M. F.”, por ishte i njoftuar se raportet nuk ishin plotësisht të kënaqshme, andaj sekretati S.M. kishte formuar komision për vlerësimin e raportit të filmit “Mysafir në Sofër”. Konsideron se kontratën e ministrit pararpak e ka konsideru si trashëgim të obligimeve financiare në shumë prej 800 mijë eurove ku hynë edhe shuma prej 100 mijë eurove për “M. F.” Në vazhdim thekson se për herë të parë në vitin 2008 QKK i është ndarë bugjeti në shumë prej 400 mijë eurosh, pohon se projekti “Mysafir në sofër” nuk ka kaluar nëpërmes QKK por është realizuar në kuadër të politikave programore për përkrahjen e kulturës. Vazhdon duke sqaru se filmat që realizohen në Kosovë nuk do të thotë të kalojnë vetëm përmes QKK sepse neni 2.2 i Ligjit për Kienmatografinë përcakton se me veprimtari kinematografike mund të merren edhe subjete të tjera përfshirë edhe Ministrinë e Kulturës. Në fund thekson se meqë projekti filmik ka qenë i aprovuar nga qeveritë e atëhershme, shikuar nga kjo qasje ka qenë i obliguar të përmbushë kontratën ekzistuese, në këtë bazë pranon se ky projekti filmik nuk është proceduar as përmes Divizioni për Kinematografinë, meqë ka konsideruar se është detyrim i trashëguar.

Dëshmitari V. B., në vazhdim në shqyrtim të tanishëm gjyqësor, jep arsyetimin e transferimit të mjeteve buxhetore nga një vijë në tjetrën, duke thënë se ka bërë kërkesë në MEF përshtatshmërisht me nenin 30 të Ligjit për meanxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë 03/L-048, kontratën e datës 30.01.2006 e ka trashëguar, ndërsa me aneks kontratë ka pretenduar që e njëjta të jetë më e favorshme për MKRS, ri pohon se ka parë skenarin e filmit “Mysafir në Sofër” dhe me qëllim të mos ketë ndryshime apo devijime, ka kërkuar që e njëjta të protokolohet, thotë edhe më herët ka ekzistuar sinopsisi, pranon se ka pasur takime me producentin A. por edhe me koproducentin Ch. dhe I., të cilët i kanë kërkuar implementimin e kontratës ekzistuese, ndërsa nga të njëjtit ka kërkuar konfirmim me shkrim se ata janë të gatshëm të sigurojnë mjetet tjera financiare, meqë vlera e përkrahjes nga MKRS ka qenë diku 7.5% të vlerës së përgjithshme, për çka në gusht të vitit 2008 ka pranuar letër konfirmuese nga A. M., se ia ka arritur të mbajë mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar. Pastaj ripohon formimin e komisionit mbikqyrës për kjetësimin e shpenzimeve për projektin “Mysafir në sofër” dhe pas përfundimit të mandatit të tij në prill 2010, ka dëgjuar se komisioni ka kërkuar të ngritet një proces gjyqësor. Në vazhdim i akuzuari V. në pyetjen e përfaqësuesit të MKRS se “ju i keni alokuar mjetet me datë 28.10.2008, ndërsa në raport të komisionit, të datës 15.04.2010 theksohet se “M. F.”ka prezantuar fatura nga viti 2006-2007-2008”, i akuzuari V. prëgjigjet se nuk ka qenë ministër në kohën kur janë dhënë

vlerësime. Ndërsa në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit A. M., av. G. V., se “ a ka nënkuptu alokimi i mjeteve prej 100 mijë euro për fazën e parë se të njëjtat janë aloku për fillimn e xhirimeve të filmit” i njëjti përgjigjet duek thënë se nuk është ekspert të vlerësojë se çka përfshinë faza e parë.

Për projektin “Mysafir në Sofër” prej alokimit të parave në vitin 2008 e deri në mars 2010 thotë se është obligim i departamenteve me e mbikqyrë. Sa i përket formimit të bordeve apo këshillave profesionale për projekte të caktuara, thotë se nuk ka pasur obligim përveç nëse i është dashtë ndonjë ndihmë profesionale, edhe pse ka pasur këshilltar nga kabineti i tij.

- **Mbrojtja e të akuzuarit F. F.**

I akuzuari F. F. në mbrojtjen e vet ka deklaruar se mbetet ranë deklaratës së dhënë në në shqyrtimin e mëprashëm gjyqësor, në të cilin ka deklaruar se ka lidhur një kontratë në vitin 2006 për projektin e filmit “P. C.” për subvencionimin e një pjese financiare të projektit, prej 30%, që ka arritë shumën prej 220 mijë euro, ndërsa premiera e filmit është shfaqur në vitin 2012. Pohon se ka lidhur një Ujdi gjyqësore me përfaqësuesit e MKRS për realizimin e projektit filmik në periudhë prej një viti ose kthimin e mjeteve, se projekti ka qenë produksion ndërkombëtar i gjiruar në gjashtë shtete, se të gjitha faturat janë përmbyllë para afatit që i është dhënë me ujdi gjyqësore, ka dorëzuar projektin, vetëm premiera është shfaqur pas afatit në teatrin ABC, në vazhdim shpjegon se në gjirimet filmike ndodhin vonesa, ato mund të zgjasin 3-5 vjet apo më shumë, pranon se i ka kuptuar dhe i ka pranuar obligimet që kanë dalë nga kontrata dhe nuk ka bërë ndonjë vërejtje me shkrim por vetëm ka mbajtur takime me ministrin H., pranon se ka marrë nga MKRS 188 mijë euro, ndërsa prezantimin e arsyesimit të shpenzimeve e ka bërë në vitin 2009, kurse në vitin 2010 ka filluar xhirimet.

Në prokurori me datë 28.03.2012, ka deklaruar se ka dorëzuar në MKRS draft skenarin dhe dokumentet përcjellëse, si planin financiar ku është paraqit kostoja e filmit në shumë prej 600 mijë euro dhe me datë 27.02.2006 ka nënshkruar kontratën me ministrin H., thekson se ka dorëzuar skenarin në bazë të konkursit të shpallur por nuk posedon dëshmi për shpalljen e konkursit, gjatë vitit 2006 ka pranuar nga MKRS shumën prej 188 mijë euro në xhirollogarinë e kompanisë, pranon se ka pasur obligim të fillojë gjirimin e parë më së largu pesë muaj nga dita e lidhjes së kontratës dhe të përfundojë filmin më së voni 12 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës, ka raportuar në MKRS për situatën rreth implementimin e projektit filmik, përkatësisht për ngecjet e krijuara për shkak të vdekjes së koproducentit gjerman, si dhe për tërheqjen e koproducentit tjetër, andaj i njëjti është orientuar në gjetjen e koproducentëve të tjerë, ashtu që në vitin 2009 ka gjetur kompaninë angleze “L. E. B.” e cila ka siguruar mjete financiare për xhirimin e filmit “Në kërkim të Larës”, në shtator 2010 ka filluar gjirimin e filmit dhe përfundimisht me datë 10.05.2011 e ka njoftu MKRS se filmin ka përfunduar dhe e ka dorëzuar kopjen e parë në DVD, mirëpo nga MKRS asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje. Në vazhdim i njëjti pranon se me datë 01.03.2011 ka pasur obligim sipas Ujdisë gjyqësore me ia kthy mjetet MKRS në shumë prej 188 mijë euro me kamatë, ose me e kry filmin sipas kontratës.

I akuzuari F., në vazhdim, në shqyrtimin e tanishëm gjyqësor, ka deklaruar se është pronar i kompanisë filmike “C. P.” e cila merret me realizimin dhe distribuimin e filmit, pranon se ka marrë pëlqimin e fundit nga MKRS me datë 14.04.2006 për qëllim të realizimit të projektit filmik “P. C.”, më pas ka lidhë kontratë me datë 27.02.2006 me MKRS-ministrin H., pajtohet me kushtet e kontratës të precizuara në nenin 7,13, sqaron se ka filluar me parapregaditjet, gjetjen e lokacioneve në Kosovë, Shqipëri e Gjermani dhe gjetjen e aktorëve, filmi ka qenë produksion ndërkombtar, se është vonuar në realizimin e filmit për shkak se në nëntor të vitit 2006 producenti kryesor gjerman ka ndërruar jetë e pastaj edhe producenti tjetër është tërhequr nga projekti, e për këtë e ka njoftuar ministrin H. gjatë takimeve të drejtëpërdrejta, por nuk ka ndaluar me realizu synimin e tij, ka gjetur bashkëproducent të tjerë në nivel ndërkombëtar, mirëpo pohon se gjatë periudhës 2008-2009 ndaj tij është ngrit një padi në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë ku dhe ka arritur një marrveshje të datës 18.01.2010, pohon se gjirimet dhe fotot e gjirimeve i ka dërguar në MKRS dhe i ka njoftuar se filmi është në postproduksion, përkatësisht në fazën e fundit, në rregullimin e ngjyrave dhe ka premtuar se filmi i kompletuar me “time code” në mes të ekranit do të dorëzohet në fund të muajit prill 2011. Pohon se i ka arsyetu mjetet e mara nga MKRS për realizimin e filmit, miratimin e pagesës e ka bërë personi zyrtar në MKRS, pagesat janë mbyllë me 24.01.2011, në vazhdim thekson se ka bërë marrëveshje me kompaninë “G.” për shfaqjen e premierës së filmit “Në kërkim të Larës” dhe ky film është shfaqur me datë 02.07.2012, për këtë ekziston edhe ftesa në shkresa të lëndës si dhe DVD.

Në pyetje të përfaqësuesit palës së dëmtuar për të sqaruar nëse mjetet në shumë prej 188 mij euro i ka marë para se të filloj gjirimin e filmit, dhe nëse filmin në DVD e ka shfaqur në MKRS apo vetëm e ka dorëzuar në kovertë, i akuzuari F. nuk dëshiron të përgjigjet, ndërsa në pytjet e gjykatës nëse e ka realizuar gjirimin e filmit “P. C.”, i akuzuari përgjigjet se filmi ka mbajtur emrin “Në kërkim të Larës” ndërsa si titull pune ka pasur emërtimin “P. C.”, spjegon se emërtimin e filmit e ka ndryshuar në fund si emërtim i kapshëm për filmin, ndërsa në pytjen e gjykatës nëse ka ndërmarë ndonjë veprim me amandamentu, me plotësu kontratën ekzistuese, përderisa ka ndërru projektin i kuzuari thekson se vetëm është ndërruar producenti nga ai gjerman në atë anglez dhe personazhet vijnë nga Anglia dhe jo nga Gjermania, ndërsa filmi është i zhanrit të njejtë dhe ka temë të njejtë dhe se në MKRS e ka dorëzuar në fillim të muajit maj 2011.

- **Mbrojtja e të akuzuarit A. M.**

I akuzuari A. në mbrojtjen e vet thekson se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e më parshëm gjyqësor, në të cilin ka shpjeguar saktësisht fazat e gjirimit të një filmi të metrazhit të gjatë, zhvillimin e skenarit, siç është faza e paraprodhimit të filmit, prodhimi dhe postprodhimi ku hynë montazha editimi i zërit, ngjyrimi dhe faza finale e distribuimit të filmit dhe shfaqjes në kinema. Në vazhdim thekson se parat e mara nga MKRS nuk ka pasur as një shansë për të filluar gjirimin e filmit, ajo fazë i dedikohet matjeve profesionale, që në këtë industri nënkupton përzgjedhjen e stafit kreativ, regjisorit, skenaristit, aktorëve, zgjedhjen e lokacioneve, dhe krejt kjo është e spjeguar në librat e prezentuar në gjykatë, pohon se ka kryer 95% të punës në fazën e paraprodhimit, dhe këtë punë të kryer e ka dorëzuar projektin në MKRS dikun në vitin 2010 dhe prej atëherë ka humbur çdo komunikim dhe nuk ka marrë asnjë përgjegje nga MKRS, pohon se nuk ka marë asnjë njoftim nga MKRS lidhur me validitetin e kontratës së nënshkruar të datës 30.01.2007.

Në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor ka shpjeguar se është aktor, profesor në Akademinë e Arteve, producent i filmit si dhe pronar i kompanisë filmike “M. F.”, projekti filmik “Mysafir në sofër” thekson se është ide e tij dhe e shkrimtares Ch. J. nga Afrika e Jugut, të cilën në vitin 2000 e ka sjellë në Kosovë dhe kanë mbledhë rrëfimet e vërteta të luftës për të krijuar një skenar që është bazë për realizimin e një filmi si edhe me koproducentin I., periudha e shkrimit të skenarit ka zgjatuar deri në vitin 2004,2005, projektin ka menduar t’a realizojë me një buxhet prej katër milion euro, është takuar me ministrin dhe i është sygjeruar të kalojë edhe në mbledhje të Qeverisë, pastaj i është aprovuar shuma prej 350 mijë euro dhe është konkretizuar me kontratë të vitit 2007, e cila nuk është implementu deri në vitin 2008 kur është nënshkruar aneks kontrata dhe u rikonfirmua mbështetja dhe rifillimi i zbatimit të kontratës paraprake, me pagesë të kështit të parë prej 100 mijë euro, me çka kanë filluar fazën e paraprodhimit që e bënë skenarin një aset cilësor, kurse gjirimet e filmit nuk mund të bëhen para se të kryhet konstruksioni financiar, thekson se për shumën e pranuar ka prezantuar në MKRS rrjedhën e shpenzimeve me fatura. Në vazhdim thekson se komisioni i MKRS ka keqkuptuar duke menduar se duhet të bëhen disa xhirime, pa e kuptuar procesin e prodhimit të filmit, në fakt me 100 mijë euro ka arritur në përfundim të punëve që parashihen në fazën e paraprodhimit, ka punuar për këtë fazë intenzivisht një vit e gjysmë, pasi që vendi ka shkuar në zgjedhje, shpjegon se pesë mijë euro kanë qenë në llogari të kompanisë së tij kur i është ndërprerë kontakti në qershor 2010, shpjegon se në fazën e paraprodhimit ku ka ngecur bëhet përzgjedhja e stafit, lokacionit, skenarit, aktorëve, ka bërë audicione për aktorë, vizita të ndryshme. Në vazhdim thekson se skenari i filmit bashkë me sinopsisin i janë prezantuar Departamentit të Kulturës, ku edhe janë protokoluara, për çka sjell edhe librin e protokolit që mbanë datën 19.09.2008 kur edhe është nënshkruar aneks kontrata.

I akuzuari A. M., në prokurori me datë 19.12.2011, ka deklaruar se pas nënshkrimit të kontratës në janar 2007, së shpejti ishte njoftuar nga MKRS se kontrata nuk është valide, ngase nuk është respektuar procedura për nënshkrime. Pohon se kompania e tij i kishte dy xhirollogari, atë kryesoren dhe nënllogarinë për projektin “Mysafir në Sofër”, por ministri B. për ndonjë arsye ka gabuar dhe paratë i ka transferuar në xhirollogarinë kryesore.

- Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimi i provave

Pasi të akuzuarit nuk pranuan fajsinë për veprat penale që u vihen në barrë me aktakuzë, gjykata vazhdoi procedimin e çështjes me shtjellimin e provave, dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPP, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga provat e prezantuara në shqyrtim gjyqësor, si në vijim:

- Pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarve,
- Nga dëshmitë e dëshmitarëve K. B., K. G., A. T., E. Sh., Z. H., B. K. dhe A. Ç.,
- Nga leximi i deklaratave të dëshmitarëve Ch. J., S. M. dhe F. B.,
- Nga provat materiale të bashkangjitura shkresave të lëndës,
- Pjesërisht nga vlerësimi i ekspertizës financiare,

- Nga vlerësimi i aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.13/2011 i datë 28.02.2012 dhe vendimeve të tjera gjyqësore,

Nga provat e lartshënuara, të administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata fillimisht sqaroi rrethanën e rekomanduar nga Gjykata e Apelit, se kjo çështje është e natyrës juridiko-penale, e nuk ka të bëjë me raport civilo-juridik apo ekonomiko-juridik, andaj në këtë kontest, konstatoi arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat i karakterizojnë veprat penale që u vihen në barrë të akuzuarve, si dhe veprimet konkrete të ndërmara nga të akuzuarit, në mënyrë që të përcaktohet ekzistimi i elementeve inkriminuese në veprimet e secilit të akuzuar. Gjykata vlerëson se në këtë proces gjyqësor kemi të bëjmë me përfshirjen e të akuzuarve në një raport penalo-juridik, për faktin se nga momenti kur të akuzuarit A. H. e V. B., duke qenë secili në pozitë të ministrit, me vetëdije kanë lidhë një kontratë duke bërë shkelje të dispozitave të parapara ligjore, të njëjtit kanë hyrë në zonën inkriminuese, ndërsa dy të akuzuarit tjerë A. M. dhe F. F. kanë hyrë zonën inkriminuese në momentin kur të njëjtit nuk kanë prezantuar dëshmi reale, të sakta të kërkuara me ligj për fitimin e parasë publike për destinacionin që pretendonin, ndërsa dëshmitë e sjellura për arsyetimin e shpenzimit i kanë sjellë të rreme. Përndryshe sikur e tërë çështja të përfundonte vetëm me mospërbushje të elementeve të kontratës së ligjshme, apo nëse palët kontraktuese në çfarëdo mënyre nuk pajtohen, apo pajtohen ndryshe, apo vonohen në plotësimin e kushteve nga ajo kontratë, të njëjtit mund të kishin vazhduar kontestin e tyre në rrugë ligjore, qoftë në procedurë juridiko-civile apo nëpërmjet gjykatës ekonomike kur dy palët janë subjekte ekonomike dhe atëherë do të mund të konsiderohej raport civilo-juridik apo ekonomiko-juridik.

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata procedoi me provat tjera duke dhënë vlerësimin për të njëjtat dhe faktet e provuara nga ato prova, nga të cilat vërtetoi edhe gjendjen e lartshënuar faktike.

- Deklaratat e dëshmitarëve

Nga dëshmia e dëshmitarit **B. K.**, vërtetohet fakti se, i njëjti si ish-kryeministër i Kosovës, gjatë periudhës kohore mars 2005- mars 2006, ka pritur në takim një producent të huaj zonjën Ch. J. me aktorin A. M. dhe, në takim është biseduar për një projekt ndërkombëtar filmik, që për temë do të ketë ngjarjet e luftës së fundit në Kosovë dhe se, ai ka shkruar një letër në të cilën ka shprehur përkrahjen e tij për projektin që t'u shërbej producentëve që të gjejnë donator për filmin dhe, poashtu e ka lënë të hapur mundësinë që në të ardhmen Qeveria e Kosovës, të gjejë modele për të përkrahur projektin filmik, mirëpo në këtë letër nuk është saktësuar shuma financiare dhe kjo letër nuk ka qenë e natyrës detyruese, por ka qenë një nxitje për të financuar.

Nga dëshmia e dëshmitarit **A. Ç.**, vërtetohet fakti se, i njëjti ishte kryeministër i Kosovës gjatë vitit 2006-2007, dhe gjatëasaj kohe ministri H. ka prezantuar projektin "Mysafir ne Sofer" në mbledhjen e qeverisë dhe, për sa i kujtohet ky ka qenë projekt i filluar para se ai te vie ne pozitën e kryeministrit. Më tutje dëshmitari ka shpjeguar shkresën e datës 13.06.2006, nr. 125/06, të nënshkruar nga ai vetë si kryeministër, se është i përpiluar në gjuhën angleze dhe ka të bëjë me kërkesën e zonjës Ch. J. dhe të A. M. si dhe me konfirmimin e vet dëshmitarit se, projekti e ka

mbështetjen e Qeverisë së Kosovës, e cila do të vendosë se si mund të kontribuojë në financimin e këtij projekti. Mirepo deshmitari ka pohuar se natyra e perkrahjes se tij ka qene parimore dhe vazhdim i perkrahjes se paraardhesit të tij dhe se, nuk ka qenë në dijeni për modalitetet tjera, sepse në asnjë mënyrë nuk ka qenë i implikuar.

Të dy deklaratave të ish kreministrave gjykata ia fali besimin, meqë të njëjtit sqaruan se projektin e kanë perkrahur në parim por nuk e kanë detyruar asnjërin nga ministrat t'a aprovojnë patjetër.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitares **K. B.**, zyrtare për kinematografi ne MKRS, e cila në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratave të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm të datës 29.09.2012, rezulton se lidhur me projektin filmik “Mysafir ne Sofer”ëshë kërkuar mendimi i divizionit ku ajo ka qenë duke punuar, me ç’rast ajo bashkë me kolegun e saj K. G., i cili ishte udhëheqës i Divizionit, kanë vërejtur se bëhet fjalë për kontratë me shumë të lartë parash, se dokumentacioni i paraqitur është jo i kompletuar, kanë konstatuar mungesen e autorizimit te ministrit per nënshkrimin e kontratës, per te cilen drejtoresha A. T. është arsyetuar se arsyetimi ekziston dhe emailin e konsideron si autorizim, mungesën e skenarit te filmit i cili është dashur të shqyrtohet paraprakisht nga bordi ad hoc te cilin ministri do te duhej ta formonte ne munges te bodrit të QKK si dhe mungesen e një vendimi për projektin “Mysafir ne sofer”. Së bashku kanë paraqitur vërejtjet e tyre për mos respektimin e kritereve dhe për parregullsitë e konstatuara, tek ministri A. H., andaj ministri në bazë të vërejtjeve të tyre a ka stopuar dhe nuk e ka paguar çmimin për cilin është zotuar ministria. Mirepo siç ka theksuar deshmitarja, kjo kontratë nuk është anuluar, përkohsisht ka stagnuar dhe më pas ka vazhduar me ardhjen e ministrit V. B., i cili ka lidhur aneks kontratë, me ç’rast Divizionin e kulturës e ka anashkaluar tërësisht dhe i është drejtuar zyrtares e cila nuk ka pasur kompetencë të nënshkruaj lejimin e mjeteve financiare E. Sh., ndërsa në vend te K. G. është nëshkruar N. G., zyrtare e promovimit. Po ashtu ka shtuar se, me përjashtim të projekteve te vogla që janë miratuar përmes sekretarit dhe atë kryesisht dokumentare dhe filma të metrazhit të shkurtër, në të gjitha rastet tjera janë formuar borde ad hoc lidhur me përzgjedhjen e filmit, pra, edhe pse ka qene detyrim formimi i këtij bordi, per projektin filmik “Mysafir ne Sofer” kjo nuk ka ndodhur.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit **K. G.**, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratave të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm të datës 05.12.2014, në të cilin ka deklaruar se nga viti 2002 deri me 2011 ka punuar si udhëheqës i Divizionit të Arteve Skenike, Muzikore dhe Pamore ne MKRS, rezulton se nga viti 2002 deri më 2006 ka ekzistuar Bordi i përhershëm në të cilin janë marë vendime për aprovimin e projekteve filmike, të cilat projekte janë shqyrtuar dhe vleresuar ne mënyre profesionale, ndërsa vetë deshmitari ka punuar në cilësin e kordinatorit te bordit. Detyra e bordit ka qenë të aprovojë projekte filmike të paraqituara ne zyrën e MRKS, dhe se ka qenë i përbërë nga njerëz profesionist të filmit dhe nuk ka pas kufizime sa i përket projekteve filmike qoftë të metrazhit të gjatë, të shkurtër, të animuar apo dokumentar, janë proceduar të gjitha ato që janë parashtruar me kërkesë të palëve. Me tutje ka shtuar se me formimin e QKK, bordi ka pushuar së funksionuari. Sa i përket projektit të paraqitur nga “M. F.” dëshmitari ka pohuar se divizioni të cilin ai e ka udhëhequr ka dhënë një vlerësim të cilin ia ka dërguar edhe ministrit H., ku kishte shprehur mendimin se nuk duhet perkrahur ky projekt filmik, pasi që i njëjti nuk i plotëson kriteret siç janë, mungesa e skenarit të cilin edhe pse e kanë kërkuar

nga paraqitësi i projektit, i njëjti nuk është përgjigjur në kërkesën e tyre, poashtu nuk është plotësuar kriteri i posedimit të një shume të mjeteve financiare, mirëpo edhe përkundër ktij vlerësimi, ish ministri H. fillimisht e ka përkrahur ndërsa më vonë ka ndërpre mbështetjen për atë projekt. Më tutje, ka shtuar se me ardhjen e ministrit V. B. është lidhur një aneks kontratë, edhe pse divizioni ka mbetur pranë vlerësimit të mëparshëm lidhur me projektin. Gjykata e ka vlerësuar këtë dëshmi si dëshmi reale, e cila po ashtu verteton faktin se lidhur me perkrahjen e projekteve filmike para se të funksionalizohet QKK, ka ekzistuar Bordi profesional, i cili parapakisht ka vlerësuar projektet filmike te cilat kane kerkuar mbështetje ne ministri, ndërsa konkretisht projekti filmik “Mysafir ne sofer”, nuk ka kaluar neper nje vleresim te tille qoftë te bordit profesional, apo të QKK dhe se me rastin e nenshkrimit te kontartes, nuk eshte paraqitur skenari apo ndonje provë per ndonje shume financiare te siguaruar për këtë projekt filmik.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitares K. B. e poashtu edhe të dëshmitarit K. G. si dëshmi të sinqerta dhe objektive, jo kunderthënëse dhe në pëputhje me të gjitha deklaratat dhe dëshmitë e mëparshme e ne harmoni edhe me provat tjera ne shkresat e kesaj lënde, andaj edhe e ka bazuar vendimin gjyqesor në këto dëshmi.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitares **A. T.**, e cila po ashtu ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqesor të datës 18.02.2015, rezulton se, ajo si drejtoresha e Departamentit të Kulturës në MKRS ka pasur autorizim me shkrim nga ministri H. për nënshkrimin e kontratës për projektin filmik “Mysafir ne sofer”, se fillimisht nga producenti A. M. është sjellë vetëm drafti për projektin “Mysafir në sofer”, pas dy viteve është sjellë skenari, ndërsa nuk ka pasur dëshmi lidhur me mjetet financiare për realizimin e filmit në shumën prej 3 deri 5 milion euro. Më tutje ka deklaruar se para nënshkrimit të kontratës, komplet dokumentacioni është dashur të kalojë përmes zyrës per çeshtje Kinematografike per vlerësim, por nuk i kujtohet nëse dokumentacioni ka kaluar nëpër këtë zyrë, respektivisht tek zyrtarja K. B.. Ndërsa me ardhjen e ministrit V. B. është marë vendim që të përkrahet projekti filmik “Mysafir në Sofër” në shumën prej 100 mijë euro, ndërsa dy muaj më pas ajo nuk ka qenë më në atë pozitë dhe se nuk dinë për zhvillimin e mëtejshëm lidhur me projektin.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitares **E. Sh.**, e cila ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqesor të datës 18.02.2015, rezulton se nga 17 shkurti i vitit 2003 ka punuar ne Departamentin e Kulturës në MKRS, Divizioni i promovimit-Departamenti i Kulturës- Sektori i diverzitetit kulturor, Integrim i minoriteteve apo Promovim i komuniteteve jo shumicë, rezulton se projekti filmik “Mysafir ne Sofër” i kompanis “M. F.” është proceduar me shpejtësi dhe se drejtoresha e Departamentit A. T. kishte kërkuar nga N. G. që t’a procedojë projektin në mënyrë që të paguhet paraqitësi i projektit dhe se e njëjta ka vepruar sipas urdhërit të A. T.. Po ashtu kjo dëshmitare ka deklaruar se ajo ka nënshkruar në një kërkesë që quhet fletë e verdhë, në emër të një zyrtareje që ka munguar, edhe pse pse puna e saj nuk ka pas të bëjë me fushën e filmit dhe se nuk kishte parë asgjë nga shkresat apo nga projekt propozimi dhe nuk e din se kush ka qene personi që është dashur ta bëjë vlerësimin e atij projekti filmik dhe kërkesës.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit **Z. H.**, i cili ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e më parshëm të datës 05.11.2014, rezulton se i njëjti ka qenë drejtor i QKK nga viti 2006-gusht 2011, ndërsa deri në vitin 2008 nuk është konstituuar Këshilli Drejtues i QKK, në gjysmën e dytë të vitit 2008 për herë të parë janë ndarë mjetet nga buxheti i MKRS për QKK për subvencionimin e projekteve filmike me ç'rast është përkrahur projekti i parë filmik “Gomarët e Kufirit”. Dëshmitari me tutje i pyetur nga trupi gjykues se a qëndron konstatimi që keni thënë se në vitin 2003-2004 ka qenë i formuar këshilli ad hoc për kinematografi në MKRS, i njëjti është përgjigjur se po, është e vërtetë dhe ka pasur autorizim që t'i sugjeroj ministrit në atë kohë, se cilat projekte filmike mund të realizohen, do të thotë ka bërë vlerësimin e projekteve të metrazhit të gjatë. Lidhur me vlerësimin e projekteve filmike të metrazhit të gjatë “Musafir në Sofër”, i njëjti është përgjigjur se nuk e din për këtë film, por e din se i ka shqyrtu dy filma të tjerë, “Anatema” dhe “Lotët e Kosovës”.

Gjithashtu edhe deklaratat e tre dëshmitarëve të lartshënuar A. T., E. Sh. e Z. H., gjykata ia fali besimin, meqë ishin në përputhje me njëra tjetrën, nga dëshmitë e tyre gjykata vërtetoi faktin se QKK ka qenë funksionale nga viti 2008, ndërsa Drejtoria për Kulturë në rastin e projektit filmik “Mysafir në sofër” është anashkaluar tërësisht.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit **F. B.**, deklarata e të cilit e dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor me pajtimin e palëve është lexuar, në të cilin ka deklaruar se ka qenë drejtor i QKK nga viti 2011 deri në Shtator të vitit 2013 kur edhe ka dhënë dorëheqje. Me tutje ka shtuar se QKK është kompletuar me staf dhe ka filluar të funksionojë me kapacitet të plotw nga viti 2008 e tutje. Lidhur me projektet filmike “Mysafir në sofër” dhe “P. C.”, dëshmitari ka deklaruar se këto projekte filmike nuk kanë shkuar përmes QKK, por drejtëpërdrejtë përmes MKRS se nuk ka njohuri meqenëse nuk ka pasur qasje në këto projekte gjatë periudhës kohore 2011-2013 kur ai ishte drejtor i QKK. Thekson se MKRS nuk ka financuar ndonjë projekt filmik pa kaluar nëpër QKK, më tutje ka shtuar se Ligji thotë se QKK mund të financojë deri 51% të projektit për filma të metrazhit të gjatë, ndërsa 49% parashihet t'i gjenë producenti qoftë para ose pas lidhjes së kontratës. Mjetet e QKK sipas ligjit ndahen në këste dhe atë me fillimin e xhirimit të filmit, faza e dytë në mes procesit të xhirimit dhe e treta në përfundim të xhirimit.

Nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit **S. M.**, në cilësinë e ish drejtorit të Departamentit të Kulturës në MKRS gjatë vitit 2006 dhe ish-sekretarit të përhershëm në të njëjtën ministri, të dhënë në shqyrtimin e mëparshëm, rezulton se projektet të cilat kanë kërkuar të perkraken së pari është dashur të shkojnë në departamente përkatëse, në rastin konkret në Departamentin e Kulturës në të cilin janë analizuar nga zyrtaret përkatës, për shumën deri në 5.000 euro janë miratuar nga Sekretari i përhershëm, ndërsa shumën mbi 5.000 euro nga ministri apo zëvendës ministri me miratimin e të cilëve ka filluar edhe procedura e ekzekutimit. Lidhur me projektin filmik “Mysafir në Sofër” dëshmitari ka deklaruar se nuk është në dijeni se a janë respektuar këto procedura, sepse nuk kanë pas të bëjnë me fushën ku ai ka punuar, mirëpo ka pohuar se kontrata e lidhur midis MKRS dhe kompanisë M. F. nuk është anuluar dhe nuk ka pas shprehur zëvendës zyrtarë për anulimin e saj, prandaj e njëjta ka qenë në fuqi.

Gjykata ia fali besimin edhe dëshmisë së dy dëshmitarëve të lartshënuar F. B. dhe S.M., meqë i pari shpjegoi kjo për kufizimet ligjore se deri në ç'masë QKK mund të financojë projektin për

film te metrazhit të gjatë dhe se mjetet e QKK jepen nëpër faza, në fillimin e gjirimit të filmit, faza e dytë në mes procesit të gjirimit dhe e treta në përfundim të gjirimit, ndërsa në rastin konkret procedurat nuk janë zbatuar dhe projekti nuk ka kaluar nëpër departamentin përaktës të kulturës.

Nga leximi i deshmisë së deshmitares **Ch. J.** të dhënë në shqyrtimin e mëparshëm, rezulton se është producente e filmit me përvojë 20 vjeçare dhe se me të akuzuarin A. M. është njohur dhe me të ka biseduar për realizimin e filmit “Mysafir në Sofer”, së bashku me të kanë bërë përpjekje për sigurimin burimeve financiare për këtë projekt filmik. Po ashtu ka shtuar se nga MKRS kanë marrë garancion për shumën prej 350 mijë euro, pavaresisht faktit se skenari i filmit “Mysafir në sofër” nuk është dorëzuar në MKRS, mirëpo ka pohuar se skenari ka ekzistuar por ministria nuk ka qenë e gatshme t’i dijë detajet e skenarit. Më tutje ka shtuar se pas ndarjes së mjeteve nga ministria, që sipas saj ishte shumë e vogël, ajo ka qëndruar disa herë në Kosovë, shpenzimet e per qendrimet e së cils janë mbuluar nga kompania “M. F.”. Po ashtu ka shtuar se edhe pse realizimi i projektit është ndërprerë, ajo nuk e konsideron këtë projekt të deshtuar meqenëse realizimi i këtij projekti filmik ka qenë për interes të vendit.

Dëshmisë së deshmitares Ch. gjykata ia falë besimin, ndonëse me mangësi, duke pasur parasysh se e njëjta ose është munduar t’a mbrojtë partnerin e saj ose nuk ka qenë në dijeni të saktë se i akuzuari A. ka marrë paraprakisht avanse nga MKRS, por ka menduar se qëndrimi i saj në Kosovë është mbuluar me shpenzime të kompanisë “M. F.”. Ky fakt në të cilin pretendon gjykata, u vërtetua edhe nga pohimi i të akuzuarit A. H. kur në prokurori ka thënë se i ka dhënë avanse A. M. në vlerë prej 14-15 euro, si dhe nga faturat e prezantuara nga A. i që datojnë nga viti 2006, ashtu siç pretendon edhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar.

Gjykata vlerësoi edhe provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, fillimisht vlerësoi ekspertizën financiare e cila ishte e propozuar nga të akuzuarit, e hartuar nga eksperti financiar R. B. e datës 26.09.2015, i cili gojarisht është sqaruar edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.11.2016, e të cilës gjykata pjesërisht ia falë besimin. Lidhur me shpenzimet e arsyetuara për projektin filmik gjykata ka vërtetuar se kompania “M. F.” nga shuma prej 100 mijë euro që i janë transferuar nga MKRS për subvencionimin e projektit “Mysafir ne Sofer”, është arsyetuar shuma prej 94,128.87 euro, ndërsa e paarsyetuar ka mbetur shuma prej 15,223.00 euro, që konsiston në fatura në fotokopje, fatura të pavulosura nga bleresi dhe fatura mbi 500 euro të cilave u mungon kontrata. Ndërsa të bashkëshoqeruar me ekspertizën është edhe pasqyra e shpenzimeve për realizimin e filmit “Mysafir në Sofër” sipas të dhënave të kompanisë “M. F.”, nga të cilat rezulton se natyra e shpenzimeve konsiston në udhetime, derivate, reprezentime, telefona e akomodime, apo honorare etj. Ndërkaq sa i përket konstatimeve të pershkruara në ekspertizë se lidhur me projektin filmik “Mysafir ne Sofer” lidhur me të akuzuarin A. H., me rastin e ndërprerjes së kontaktit të kompanisë “M. F.”, përkatësisht duke mos e implementuar të njëjten, nuk ka marrë mbi vete asnjë përgjegjësi, e cila konsiston me dëmtimin e buxhetit të MKRS, gjykata nuk mund t’ia falë besimin, meqenëse vlerëson se konstatime të tilla nuk janë në kuadër të angazhimit të ekspertit financiar, gjegjësisht janë në kundërshtim me nenin 136 par te KPP i cili parasheh që “Eksperti nuk mund të shpreh mendimin e tij lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit” siç ka bërë eksperti në këtë rast dhe se, në të njëjtën kohë bien në kundërshtim me vetë përmbajtjen e pjesës tjetër të ekspertizës dhe të gjeturave në të, gjegjësisht në f.12 të ekspertizës

është konstatuar se nuk është prezentuar ndonjë provë materiale me te cilën do deshmohej që nënshkrimi të kontartës t'i ketë paraprirë ndonjë projekt filmik apo ndonjë skenar i cili do vleresohej nga bordi. Poashtu konstatohet se lidhur me ndërprerjen e kontartës nuk është prezentuar ndonjë akt me shkrim mbi ndërprerjen. Gjykata nuk ja fali besimin gjithashtu konstatimeve se i akuzuari V. B. i ka shterrur të gjitha mundesit si menaxher i mirë, që MKRS të mos mbetet e dëmtuar për shumën prej 100 mijë euro, meqenëse i njejt i ka kërkuar formimin e komisionit dhe ka ushtruar padi për kthimin e mjeteve, pasi që nga vetë permbajtja e ekspertizes nuk mund të arrihet në këtë përfundim, ndërsa nën dritën edhe të provave tjera të administruar në shqyrtim gjyqesor, një konstatim i tillë nuk qendron. Më tutje gjykata i fal pjesërisht besimin konstatimeve se lidhur me projektin filmik “Mysafir në Sofër” të përfaqësura nga i akuzuari A. M., është arsyetuar shuma prej 94,128.87 euro, ndërsa të paarsyetuar kanë mbetur shuma prej 15,223.00 euro. Lidhur me shumën prej 94,128.87 euro, e cila konstatohet si e arsyetuar, gjykata vlerëson se nga të dhënat e ofruara lidhur me natyrën e shpenzimeve kundrejt projektit filmik për realizimin e të cilave janë dhënë, nuk mund të quhen të arsyetuara. Poashtu, gjykata vlerëson se arsyeshmerinë e shpenzimeve, që siç konstatohet në ekzpertizë është bërë pas dy viteve nga data e shfrytëzimit të mjeteve, nuk duhet parë vetëm në drejtimin e mbulimit të shpenzimeve me faturat e nevojshme dhe pavaresisht nga natyra e shpenzimeve, por arsyeshmërinë e shpenzimeve duhet gjykuar nga natyra e tyre dhe në lidhje me qëllimin për të cilin janë ndarë, e që në rastin konkret është realizimi i projektit filmik “Mysafir në Sofër”. Nga pasqyra e shpenzimeve rezulton se natyra e shpenzimeve konsiston në udhëtime, derivate, reprezentime, telefona e akomodime etj, që siç konstatohet në ekzpertizë përfshin shumën prej 94, 128.87 euro, dhe që mbulohen me fatura, edhe pse siç është pohuar nga eksperti në senacen e shqyrtimit gjyqesor të datës 03.11.2016, një pjesë të tyre ju mungon kontrata, janë konsideru valide si të tilla pavarësisht a kanë qenë të mbështetura në kontrata apo jo. Në këto kushte gjykata vlerëson se pretendimi që kjo shumë e parave është shpenzuar në funksion të qëllimit për të cilin janë marë gjegjësisht janë ndarë nga MKRS, është pabazë, jo vetëm nisur nga natyra e tyre por edhe nga mungesa e çfarëdo rezultait përmes të cilave do bëhej e prekshme arsyeshmeria e shpenzimeve të kësaj natyre. Po ashtu gjykata vlerëson se është e rëndësishme të referohet fakti i provuar tanimë edhe në prova tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqesor, por referuar edhe në vetë ekzpertizën se nuk ka dëshmi se kontrata të jetë mbuluar me ndonjë skenar që do ta bënte të besueshme pretendimin se, arsyeja e marrjes së parave sipas kontratës së nënshkruar dhe tani shpenzimeve të bëra është realizimi i projektit filmik “Mysafir në Sofër”.

Nga ekspertiza e lartë referuar e dt. 26.09.2015, konstatohet se lidhur me projektin filmik “Power cuts” është lidhur kontratë në mes MKRS e përfaqësuar nga ministri H. dhe kompani “C. P.” e cila kontratë nuk është protokoluuar në librat e ministrit, dhe në të cilën është paraparë që financimi i projektit filmik do bëhet nga mjetet e subvencioneve në shumë prej 220 mijë euro, që nënkupton 30% të kostos së përgjithshme të projektit, nga të cilat i është lejuar pagesa në shumën prej 188 mijë euro. Me tutje, konstatohet se ekzistojnë të meta procedurale në kontest të mospërfilljes së procedurave rreth përzgjedhjes së projektit filmik për financimin e filimit “Power Cuts”, ekzistojnë të meta profesionale lidhur me konceptin dhe permbajtjen e kontratës, ekzistojnë të meta edhe sa i përket mos respektimit të afateve për realizimin e projektit të tillë. Mirepo eksperti financiar vlerëson se projekti filmik “Power Cuts” edhe pse me vonë është realizuar dhe si i tillë duhet të konsiderohet projekt i përfunduar dhe nuk bëhet fjale për dëmtim të buxhetit të MKRS,

siç deshmohej edhe nga shkresa e protokoluar ne MKRS, me date 10.05.2011, ne te cilen eshte dorezuar nje kopje e filmit ne DVD dhe ekziston arsytim i plote i shpenzimeve te krijuara. Mirepo gjykata vlereson se ketij konstatimi te ekspertit nuk mund t'ia fal besimin, meqense te njejtin nuk e ka shoqeruar me ndonje prove qe verteton kete, ndersa gjykata ka administruar shkresen e dt. 20.10.2016 ne cilesin e proves ne te cilin konstatohet se projekti filmik "Power Ccuts", nuk konsiderohet projekt i perfunduar. Po ashtu gjykata vlereson se eshte i padrejte konstatimi i arsytimit te shpenzimeve financiare, edhe nisur nga natyra e shpenzimeve te bera, e te paraqitura nga vete i pandehuri F. F., te cilat konstatohen shpenzime te natyres se tille si blerje e mobilieve, pastaj blerje e paisjeve per veture, per te vazhduar me blerje kapucash dhe pizhamesh, dhe shpenzime tjera ne telefon, ushqim, sim kartela, pajisje kompjuterike, internet, maica "La costa", mirepo ushqimet ne restorante dhe pizzeri te ndryshme, qe shpesh ne fatura hasen si "Ushqim per film", perfshin pjesen kryesore te shpenzimeve, e qe eshte e pabaze te i quash shpenzime te arsyeshme nisur nga qellim per te cilin jane dhene mjetet financiare.

Gjykata duke vepruar sipas rekomandimit te gjykatës së instancës së dytë, vlerësoi edhe Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike te Qarkut Prishtinë C.nr.13/2011 të datës 28.02.2012, të plotfuqishëm, nga i cili vërtetohet se A. M. obligohet t'ia kthejë MKRS mjetet në shumë prej 100 mijë euro prej datës 17.01.2011 me kamatë vjetore sipas normës 35%. Po ashtu se me Aktvendimin e Gjykatës se Apelit te Kosoves Ae.nr.412/2012 te dt.18.07.2014 është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditues "M. F." dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës ekonomike të Qarkut në Prishtinë C.nr.13/2011. Ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin e datës 17.11.2014 ka refuzuar si të pathemeltë Revizionin e kompanisë "M. F." kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit 412/2012 të datës 18.07.2014. Në këto kushte duke vepruar sipas Propozimit për ekzekutim të Ministrisë së Drejtësisë si përfaqësues i autorizuar, i datës 13.05.2015, përmbartuesi privat Saranda Rexhepi, ka leshuar urdher për përmbartim, ndaj të cilit përfaqësuesi i kompanisë "M. F." ka ushtruar Prapësim, i cili Prapësim me Aktvendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.NR.1202 të datës 30.06.2016 është refuzuar si i pabazë.

Gjykata në vazhdim administroi edhe provaet tjera materiale, si Kontrata e datës 31.07.2007 e lidhur midis MKRS të cilën e përfaqëson i akuzuari H.-ministër, e i cili e ka autorizuar për nënshkrim A.T. drejtorë e Departamentit te Kulturës dhe, "M. F." përfaqësuar nga A. M.-producent, nga e cila vërtetohet se qëllimi është subvencionimi i projektit filmik "Mysafir ne sofer", ne shume prej 350.000 euro, por i cili nuk është realizuar asnjëherë.

Paraprakisht nga shkresa e datës 16.09.2005 konfirmohet mbështetja e ministrit H. për projektin filmik "Mysafir në sofër", nga shkresa e datës 17.09.2005 konfirmohet mbështetja per projektin nga ana e kryeministrit B. K., nga shkresa e datës 13.06.2006 konfirmohet se kryeministri A. Ç. është takuar me producentët Ch. J. dhe A. M..

Aneks Kontrata e datës 19.09.2008 e lidhur midis MKRS përfaqësuar nga V. B.-minister dhe "M. films" përfaqësuar nga A. M.-producent, me të cilën të cilën vërtetohet se MKRS ka marë përsiper zbatimin e kontratës së datës 30.01.2007, permes bartjes së mjeteve financiare në vlerë prej 350 mijë euro ne xhirollogarinë e "M. F.", permes kater kesteve, ku kesti i parë në vlerë prej 100 mijë euro do t'i transferohet deri me datë 08.10.2008, e qe sipas urdhërpagesës së datës

20.10.2008 vertetohet se është ekzekutuar shuma prej 100.000 euro ne llogarinë kryesore të kompanisë “M. F.”,

Më pas nga Vendimi i datës 01.10.2008 vertetohet fakti i transferimit te mjeteve financiare ne shume prej 100 mijë euro nga linja bugetore e investimeve kapitale ne linjën buxhetore te subvencioneve dhe me tutje mjetet transferohen ne llogarinë bankare kryesore të”M. F.”.

Asnjëra nga provat materiale të lartshënuara nuk janë kontestuar nga palët, sikur që nuk është kontestuar as fakti se i akuzuari F. F. ka gjeneruar shumën prej 188 mijë euro nga MKRS me datë 19.04.2006, me qëllim të realizimit të projektit filmik “P. C.”, për të cilin ka lidhur kontratë me minsitrin A. H. me datë 27.02.2006,

Shkresa e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik Nr.28/2012 e datës 16.02.2012 vërtetoi se bazuar ne paragrafin 1 të nenit 2 dhe në paragrafin 2 te nenit 3 te Lgjit per prokurimin publik, vetem nese filmi financiohet nga fonde tjera (jo nga fondet publike) ne bazë të një marrëveshje, përjashtohet zbatimi i këtij ligji, kështu që në të gjitha rastet kur shfrytëzohen fondet publike, duhet të zbatohen rregullat dhe procedurat e praktuara me Ligjin për prokurorimin publik.

Nga Raporti final i auditimit mbi pasqyrat financiare të MRKS për vitin e përfunduar 31.12.2007, faqja 13, vërtetohet se lidhur me projektin filmik “P. C.” deri ne korrik 2006 ka marë 193 mijë euro, megjithatë nuk ekziston asnjë dëshmi/informatë nëse filmi kishte filluar të realizohet, edhe pse kompania filmike “C. P.” ka qene e obliguar që ta perfundojë filmin ne teresi brenda 12 muajve nga data e nenshkrimit te kontartes, pra në shkurt/mars 2007. Me tutje konstatohet mungesa e kontrollit dhe monitorimit të nevojshëm te projekteve ne funksion te sigurimit te shfrytezimit adekuat te tyre, fakt ky që pranohet edhe nga MKRS e cila pohon se nuk ka raport detal se deri ku ka arritur në realizimin e projektit filmik nga ana e kompanisë ”C. P.”, mirepo siq rezulton nga “C. P.” i eshte thene se deri ne 1 gusht 2008 do sjellin raportin e pergjithshem te punes dhe te arriturave si dhe raportin financiar.

Nga raporti final i auditimit mbi pasqyrat financiare të MKRS për vitin e përfunduar 31.12.2008, faqja 17, konstatohet se projekti filmik “Musafir ne sofer” eshte subvencionuar pa konkurs paraprak, ne mungesëte skenarit dhe pa vleresim te projektit nga nje juri profesionale, siç parashihet me Ligjin për Kinematografinë 2004/22 dhe është rekomanduar që nënshkrimi i kontratave dhe obligimeve fiannciare të bëhet duek respektuar në plotnë kornizën ligjore në fuqi.

Vërejtje tjetër ka qenë fakti se pagesat janë bërë për projekte ende të parealizuara, se MKRS nuk i monitoron projektet për të konfirmuar progresin dhe shfrytëzime parasë publik, ndërsa MKRS është pajtuar me të gjeturat e auditimit.

Lidhur me projektin filmik “Mysafir në sofër” nga vlerësimi i Shkresës-Rekomandimi për projektin filmik “Mysafir ne Sofer” i datës 07.03.2007, rezulton se zyrtarja per kinematografi K. B. i është drejtuar ministrit të MKRS, A. H., përmes së cilës shkresë ka reaguuar lidhur me mos respektimin e procedurave për financimin e projektit filmik “Mysafir ne Sofer”, duke vene ne pah se te njejtit i mungon skenari, si kusht elementr per vleresimin e projektit, se paraprakisht nuk ka

marë miratimin e bordit i cili duhet të themelohej për vlersimin e vlerave artistike të tij dhe se i gjithë dokumentacioni që i është paraqitur, është një sinopsis një faqesh.

Nga shkresa MKRS-Informatë për raportin financiar për projektin “Mysafir në Sofër”, e datës 10.09.2010 vërtetohet se divizioni i financave lidhur me projektin ka konstatuar këto mangësi: Të gjitha faturat janë fotokopje, faturat janë të pavulosura nga blerësi, faturat me vlerë mbi 500 euro ju mungojnë kontratat, tabela buxhetore për vitin 2008 ka mungesa të faturave në vlerë prej 8,338.18 euro, tabela buxhetore për vitin 2009 ka mungesa të faturave në vlerë prej 618.98 euro, tabela buxhetore për vitin 2010 ka mungesa të faturave në vlerë prej 394.05 euro, po ashtu se nga vlera 100 mijë euro, A. M. ka sjellë mbulesë me fatura në vlerë prej 84.777 euro ndërsa vlera prej 15 223 nuk ka mbulesë me fatura.

Nga Vendimi i datës 10.03.2010 i MKRS, i Sekretarit të Përhershëm, vërtetohet se i njëjti ka formuar komisionin prej katër zyrtarëve të MKRS për monitorimin dhe përgatitjen e raportit për ecurinë e filmit “Mysafir në Sofër”.

Nga shkresa e datës 27.08.2010, MKRS e informon A. M., se nuk është e gatshme të përcjellë projektin dhe kërkon të kthejë mjetet në shumë prej 100 mijë euro në Bugjetin e Kosovës, e më pas paraqet padi në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë.

Nga shkresa e MKRS nr.814/2012 të datës 05.04.2012 të drejtorit të Departamentit Ligjor të MKRS S. K. drejtuar PPQ në Prishtinë, nga e cila vërtetohet se nuk janë siguruar dokumente në origjinal për arsye se kanë qenë të paprotokoluara përmes Arkivit të MKRS, me përjashtim të Aneks Kontratës së datës 19.09.2008 e lidhur midis ministrit V. B. dhe kompanisë “M. F.” e gjetur tek Arkivi i ministrit. Në të njëjtën shkresë thuhet se nga Departamenti i Kulturës nuk ka ekzistuar asnjë konkurs për filma dhe nuk ka ekzistuar asnjë bord i brendshëm apo i jashtëm për të vlerësuar këtë projekt.

Nga shkresa e datës 20.10.2016, vërtetohet se MKRS Departamenti i Kulturës, ka informuar zyrtarin ligjor të Avokaturës shtetërore, se për projektet filmike “Mysafir në sofër” (M. F.) dhe “P. C.” (C. P.), deri me tani nuk është dorëzuar dokumentacion me të cilin deshmohet se këto projekte janë përfunduar, gjegjësisht këto dy projekte nuk janë të kompletuara në aspektin e arsyetimit financiar sipas obligimeve të mara në kontratë.

Provave të lartshënuara materiale gjykata ia falë besimin e plotë ngase të njëjtat janë të besueshme, të siguruar në mënyrë zyrtare, dihet burimi i secilës provë, andaj si të tilla janë të pranueshme.

Nga 15 librat e prezantuara nga i akuzuari A. M., gjykata vlerësoi se të njëjtat përfshijnë kryesisht provat e sipërshënuara, të shoqëruara edhe me fotografi e prova të tjera të cilat janë prodhuar kryesisht në vitet pas kohës së ngritjes së aktakuzës.

- **Fjalët përfundimtare të palëve**

Në vazhdim të procedimit të çështjes, Prokurori i Shtetit, deklaroi se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor, përveq pikës I të dispozitivit të aktakuzës, për të akuzuarin A. H., për të cilën ka arritur parashkrimi absolut, dhe se gjate gjithë ketij shqyrtimi gjyqësor janë prezentuar deshmi dhe prova te mjaftueshme që vertetojnë se te akuzuarit A. H., V. B., F. F. dhe A. M., secili veq e veq, kanë kryer veprat penale ër të cilat akuzohen, kjo, për faktin se në veprimet e gjithë të akuzuarve manifestohen elementet e atyre veprave penale. Ndersa sa i përket ekspertizës financiare, i ka propozuar gjykatës që të njëjtën të mos e pranoi si provë, ngase e njëjta është hartuar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale, e që pas shqyrtimit nga trupi gjykues do të vërehet se e njëjta nuk i përmbush tiparet e përcaktuara me ligj, andaj si të tillë ta hudh si të pa bazuar.

Perfaqësuesi i pales se demtuar Sh. H. sipas autorizimit, ne fjalën përfundimtare te paraqitur me shkrim por te elaboruar edhe gojarisht, ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, duke shtuar se i akuzuari F. F., MKRS e ka dëmtuar me 188 mijë euro lidhur me projektin filmi që kurrë nuk e ka kryer, i cili asnjëherë në publik nuk është shfaqur, dhe se nga MKRS i njejtë nuk është pranuar si projekt i përfunduar, gjithashtu kompania filmike M. F., e ka dëmtuar MKRS me 100 mijë euro. Ne fund ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, duke i propozuar gjykates që të obligojë të akuzuarit A. M. kthimin e borxhit ne shume prej 100 mijë euro, dhe te akuzuarin F. F. kthimin e borxhit ne shume prej 188 mijë euro siq edhe ka marrur obligim ne baze te Ujdisë gjyqesore te lidhur me date 18.01.2010.

Mbrojtësi i të akuzuarit **A. H., av. T. B.** në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet pranë fjalës përfundimtare të prezantuar në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor ne te cilën ka pretenduar se lidhur me veprën penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit te saj nga neni 422 te KPK per te cilën parashihet dënimi me burgim prej 6 mujve deri ne 5 vite ne kuptim te nenit 106 par.1 pika 1.4 te KPK ka ardh deri te parashkrimi i ndjekjes penale, meqenëse sipas aktakuzës veprimi i fundit faktik eshte me date 30.01.2007, ndërsa aktevendimi i prokurise se qarkut ne Prishtine per fillimin e hetimeve ndaj te akuzuarit A. H. eshte nxjerr me 27.02.2012. Me tutje ka pretenduar se me asnjë dëshmi relevante nuk eshte vërtetuar se i mbrojturi i tij A. H. si person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i ka tejkaluar kompetencat, ose nuk i ka përmbush detyrat zyrtare te tij me qellim qe te përfitoj çfaredo dobie per veten ose personin tjetër apo qe te shkaktoj dem personit tjetër, ose qe seriozisht ti shkel te drejtat e personit tjetër. Ne kete drejtim argumenti me i fuqishëm per pafajsin e mbrojturit te tij thotë se eshte ekspertiza financiare.

Mbrojtësi i të akuzuarit **V. B., av. D. R.**, gjithashtu ka prezantuar fjalën përfundimtare në formë të shkruar dhe të njëjtën e ka elaboruar gojarisht, ne te cilen ka theksuar se gjate gjithë ketij shqyrtimi gjyqësor eshte vertetuar se ne veprimet e te mbrojturi te tij V. B. nuk konsumohet vepra penale keqperdorim i pozites zyrtare. Me tutje ka shtuar se te mbrojturit te tij i eshte kerkuar implementimi i kontrates se lidhur me heret midis “M. F.” dhe MKRS per mbeshtetjen e projektit te filmit “Mysafir ne Sofer” dhe ne funksion te zbatimit te kesaj kontrate i mbrojturi i tij V. B. ka lidhur aneks kontraten ne te cilen jane detajuar te gjitha detyrimet e kompanisë “M. F.”, dhe me pas ka lejuar transferimin e mjeteve ne shume prej 100 mijë euro, nga linja e subvencioneve, pasi qe kishte marrur pelqimin nga MEF, kishte shikuar gjithë dokumentet e nevojshme dhe ishte mbeshtetur nga ish kryeministrat A. Ç. dhe B. K.. Me tutje ka shtuar se formularin e kërkeses zyrtare per shpenzime-letra e verdhe qe mbane daten 14.10.2008 e kane nenshkruar personat e autorizuar siq jane zyrtari administrativ i departamentit, zyrtari i autorizuar i departamentit, zyrtari

i zotimit, zyrtari certifikues dhe zyrtari i thesarit dhe ne mesin e tyre nuk figuron nënshkrimi i ministrit B., cka tregon se lidhur me kete pages gjithcka eshte transparente dhe e ligjshme. Po ashtu mbrojtja ka theksuar se duke u mbeshtetur ne nenin 3 te aneks-kontartes ministri B. ka kerkuar nga sekretari permanent S. M. qe te formoje komisionin per monitorimin dhe paraqitjen e raportit per ecurin e filmit “Mysafir ne sofer” dhe pikerisht pas raportit te paraqitur ministri B. nderpreu financimin e fazave tjera te projektit te filmit “Mysfair ne sofer” dhe nga kompania “M. F.” kerkoj kthimin e mjeteve. Me tutje mbrojtja i referohet konstatimeve te gjetjeve te ekspertit te financave sipas te cilave ministri B. ishte nje menaxher i mire i cili shfrytezoi te gjitha mundesit qe MKRS te mos mbetet e demtuar. Mbrojtja me tutje ka shtuar se nuk eshte paraqitur asnje prove relevante se i akuzuari ka tejkalu autorizmit e veta dhe ka pasur per qellim perfitimin te ndonje dobie per kompanin “M. F.” dhe se qellimi i vetem ishte implementimi i nje kontarte te ligjshme, qe ishte detyrimi i tij si ministri dhe se lidhur me ceshtjen e realizimit te projektit filmik “Mysafir ne sofer” jashte QKK, siq eshte vertetuar edhe gjate ketij shqyrtimi gjyqesor, e njejta nuk eshte funksionalizuar deri ne vitin 2008 edhe pse ligji per te njejten eshte miratua ne vitin 2004. Andja i ka propozuar gjykates gjykates qe ne mbeshtetje te nenit 364 par 1 nenpar 1.3. te KPP, per te mbrojtur e tij V. B. te merret aktgjykim lirues.

I akuzuari **V. B.**, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tij dhe njeherit ka shtuar se të gjithë dëshmitarët e prokurorisë pa përjashtim kanë dëshmuar në favorin e palës së akuzuar, bile edhe dy dëshmitarët të cilët me direktivë të prokurores paraprake janë ndikuar dhe orientuar që të flasin vetëm për një lëndë të caktuar dhe të mos deklarohen për tjetrën. Me tutje ka shtuar se çdo formë e pagesës në MKRS paraprakisht kalon në strukturë të hierarkisë dhe pas nënshkrimeve paraprake verifikohet nga sekretari permanent i cili nënshkruhet dhe atë dokument e sjell për nënshkrimin përfundimtar te ministri, pastaj kalon përmes zyrës së financave në MKRS, e cila e dërgon shkresën në Ministrinë e Financave dhe Ministria e Financave në thesar për ekzekutim, dhe në rast të çfarëdo shkelje ligjore apo mungese të dokumentacionit secila nga këto sita apo verifikues, kanë të drejtë ta stopojnë dhe ta kthejnë pagesën apo të kërkojnë dokumente shtesë. Po ashtu ka pohuar se neni 21 i Ligjit per Kinematografin parasheh qe “Ministria e Kulturës përcakton objektivat e zhvillimit të kinematografisë”, prandaj të gjitha veprimet e tija thekson se kanë qenë të ligjshme.

Mbrojtësi i të akuzuarit **F. F., av. O. H.**, gjithashtu ka prezantuar fjalën përfundimtare në formë të shkruar dhe të njëjtën e ka elaboruar gojshisht, duke theksuar se gjate këtij procesi gjyqësor janë ofruar argumente te mjetueshme me te cilat dëshmohet pafajësia e te mbrojturit te tij, dhe rrjedhimisht edhe mos ekzistimi i veprës penale per te cilën ai ngarkohet. Me tutje ka shtuar se ndryshimi i emrit të filmit nga “Power cuts” ne “Në kërkim te Larës”, është rrjedhojë se emri “Power cuts” ka qene emër fillestar dhe nderkohe ka ndyshuar, gje qe eshte e zakonshme ne projekte artistike, mirëpo ne rastin konkret nuk kemi ndryshime ne përmbajtjen e projektit. Po ashtu pretendimi se i mbrojturi i tij ka paraqitur llogari te rreme lidhur me shpenzimet per realizimin e projektit filmik janë te paqendrueshme dhe te pa argumentuara, sepse natyra e projektit filmik kërkon këto lloj shpenzimesh ndërsa realizimi filmik ne shtetet e ndryshme ka ndikuar ne lartesis e shpenzimeve. Ne kete drejtim po ashtu nuk qëndron pretendimi i akuzës lidhur me përfitimin e shumes prej 188 mijë euro pasi qe siq konstatohet edhe ne ekspertiz projektit filmik edhe pse me vonës eshte realizuar ne tansi, prandaj si i till duhet te trajtohet projekt i realizuar. Me tutje ka shtuar se eshte e ditur se ka pasur vonesa ne realizimin e këtij

projekti prandaj ne kete drejtim eshte lidhur ujdj gjyqesore te cilës i mbrojturi im i eshte përmbajtur ne tërësi. Ne këto kushte ne kete shqyrtim gjyqesore eshte vërtetu se i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale mashtrim ne detyre nga neni 341 par. 3 lidhur par. 1 te KPK, andaj i ka propozuar gjykatës qe i mbrojturi i tij te shpallet i pafajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit **A. M., av.A. K.**, gjithashtu ka prezantuar fjalën përfundimtare në formë të shkruar dhe të njëjtën e ka elaboruar gojarisht, duke theksuar se pretendimi i prokurorise se parate jane fituar per gjirimin e filmit dhe se ato para jane shpenzuar ne kundershkrim me qellimin per te cilen ato ishin te dedikuara, nuk eshte vertetuar me asnje prove materiale si dhe me asnje deklarate te deshmitareve. Me tutej ka shtuar se Prokuroria ka kuptim te gabuar lidhur me gjirimin e nje filmi, pasi qe ajo e ngatërron nocionion “realizim i nje filmi” dhe “gjirimi i nje filmi”, pasi qe gjirimi eshte faze e fundit e realizimit te filmit, ndersa paratë jane marre per realizimin e filmit, respektivisht per fazen e pare që eshte faza pergatitore apo ajo e praproduksionit, dhe lidhur me kete faze i akuzuari A. M. ka kryer te gjitha veprimet e nevojshme, duke filluar nga perzgjedhja e aktoreve, lokacioneve per gjirim, perpunimin e skenarit, planin e detajuar te gjirimeve, ka pasur kontrata te lidhur me hotele dhe restorante, dhe se per te gjitha keto i mbojturi A. M. i ka prezentuar planin investiv, qe arsyetojnë te ashtuqatren “faza e paraproduksionit” dhe ishin ne perputhje te plote me dinamiken logjike te realizimit te projektit. Po ashtu me tutje ka shtuar se ne shqyrtimin gjyqesor nuk u argumentua se A. M. ka paraqitur llogari te rreme siq pretendohet nga prokuroria, qoft ne te gjitha te dhenat e paraqitura ose vetem nje pjese te tyre, dhe se ekspertiza e realizuar nga eksperti financiar, ne asnje pike te saj nuk thote se M. ka prezentuar llogari te rreme, perkundrazi ekspertiza thote se A. M. ka arsyetuar shpenzimet ne shume prej 94.128 euro, qe do te thote se i njëjti ne aktivitetin e theksuar me siper ka shpenzuar 95 perqind te buxhetit te alokuar nga ministria. Lidhur me vleren prej 5871 euro te cilat nuk jane raportuar ato nuk kanë qenë objekt i aktakuzes pasi që pr ato para nuk ka paraqitur llogari e rrjedhimisht nuk mund te pretendohet se jane paraqitur llogari apo fatura te rreme, mirepo te njejtat kane qene ne gjirollogarin bankare te “M. films” ne momentin e nderprerjes se kontartes. Po ashtu mbrojtja pretendon se edhe sikur me fajin e te A. M. nuk eshte realizuar projekti filmik, kjo ceshtje hyn ne domenin raporteve civilo-juridike apo raporteve ekonomiko-juridike dhe ne ansje menyre nuk permben vepren penale. Me tutej ka shtuar se vepra penale mashtrimi ne detyre mund te kryhet vetem nga personi zyrtar, dhe se kete element qenesor nuk e permbush A. M. pasi që ai nuk ka ushtruar autoritet publike apo detyre te posacme.

Në fund të gjithë të akuzuarit i mbështetën fjalën përmbyllëse të mbrojtësve të tyre.

- Vlerësimi i pretendimeve të mbrojtjes së të akuzuarve dhe të mbrojtësve të tyre

Gjykata ka vleresuar dhe analizuar mbrojtjen e te akuzuarit A. H., mirepo te njejtën e ka gjetur pjesërisht të pabazuar, pasi qe pretendimin e tij se ndoshta ka formuar bordin per vleresimin e projektit filmik “Mysafit ne sofer”, por nuk i kujtohet, gjykata e vlereson vetëm si një arsyetim të tij të zbehtë, meqë i njëjti në deklarimin e dhënë në prokurori me datë 02.04.2012, ne faqe 3, ka pohuar se “nuk eshte formuar ndonje bord per vleresimin e skenarit filmik apo projektit ne fjalë”. Pastaj pretendimi i të akuzuarit H. se ka marë vendim i cili ka qenë obligativ të respektohet, pra me nënshkrimin e kontratës siç thekson vetëm e ka implementuar vendimin e Qeverisë, gjykata e sheh të paqëndrueshëm, sikur edhe pretendimin e mbrojtjes se, projekti filmik “Mysafir ne sofer”

ka qene i perkrahur nga Qeveria e Kosoves, dhe se veprimet e ministrit H. kane qene ne funksion te zbatimit te obligimeve te marura nga Qeveria e Kosoves. Kjo, pasiqe nga shkresa e datës 17.09.2005 e nenshkruar nga ana e kryeministrit B. K., nuk rezulton se eshte marur obligim mbeshtetja financiare e projektit filmik, por, siç ka sqaruar edhe vete ish-kryeministri ne cilesin e deshmitarit ne senacen e dt. 06.09.2016, e njejta më shume ka qene një nxitje për të financuar, që tu shërbej producentëve të gjejnë donator për filmin, pa e perjashtuar mundesin që në të ardhmen Qeveria e Kosovës, të gjejë modele për të përkrahur projektin filmik. Po ashtu nga shkresa e datës 13.06.2006 nenshkruar nga ish-kryeministri A. Ç., nuk rezulton se Qeveria e Kosoves ka marur obligim subvencionimin e ketij projekti filmik, dhe siç eshte sqaruar nga A. Ç., i degjuar ne cilesin e deshmitarit ne seancen e dt.03.11.2016, permbajtja e shkreses ishte nje vazhdim i natyres se perkrahjes se meherhshme nga paraardhesi i tij, dhe se nga permbajtja e filmit nuk del ndonje modalitet per perkrahje te veçantë financiare, veçse një përkrahje parimore. Pastaj, pretendimin e të akuzuarit H. se detyrimisht kontrata është dashur të protokolohet pasi mbanë vulën e Unmik-ut, gjykata e vlerësoi si arsyetim të kotë, meqë nuk është provuar me asnjë provë se kontrata është protokoluar, në të kundërtën eshte vertetuar se kontrata e lidhur me kompanin filmike “M. F.”, eshte nenshkruar ne mungesë te dokumenteve te nevojshme, siç eshte skenari dhe garancitë e nevojshme financiare qe e bejne te besueshem nje projekt te tille filmik. Më tutje pretendimi i mbrojtjes se i akuzuari H. ka ndërprerë çdo veprimtari të “M. F.”, për shkak të mospërbushjes së obligimit nga ana e drejtorit A. M. në raport me Ministrinë, nuk qendron pasi që nuk eshte administruar asnje vendim me shkrim per anulimin e kontratës, po ashtu siq është vertetuar edhe nga deshmitari S. M., se kontrata e lidhur mes MKRS dhe kompanisë “M. F.” nuk eshte anuluar dhe nuk ka pas shkresë zyrtare per anulimin e saj. Po ashtu pretendimi i mbrojtjes lidhur me parashkrimin e ndjekjes se veprës penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit te saj nga neni 422 te KPRK per te akuzuarin H., gjykata vlereson se nje pretendim i tille ka marur pegjigje ne fazat e me hershme të kesaj pocedure gjegjesisht me Aktvendimin e Gjykates se Apelit PN.nr.309/14 te dt. 16.06.2014, ne të cilin eshtë thekesuar se parashkrimi eshte ndeprere, ne momentitin kur prokurorja i eshte drejtuar zyres se audiorit gjeneral per raportimin e auditimit.

Gjykata ka vleresuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e te akuzuarit **V. B.**, mirepo edhe preretendimet e mbrojtjes së tij i ka vleresuar si pjesërisht të pabazuara, të dhëna me qellim e shmangies nga pegjegjesia penale.Kjo, për faktin se lidhur me pretendimin se i akuzuari B. ka trashëguar nje kontratë valide dhe për rrjedhojë ka qene i detyruar ta implementoj, gjykata ka vërtetuar bazuar në provat e administruara, se i njejti ka qene në dijeni se kontrata me “M. F.” ishte lidhur në kushtet e shkeljes se Ligjit per Kinematografinë, dhe ne mungesë te permbushjes se kushteve primare siç eshte mungesa e skenarit apo besueshmeria financiare, po ashtu me rastin e nenshkrimit te aneks-kontartes, i akuzuari B. siç eshte vertetuar nga deshmitaret K. B. dhe K. G., ka shmangur tërësisht Departamentin e Kultures-divizionin e arteve. Pastaj ministri B. kishte lejuar pagesën e shumes prej 100 mijë euro ta nenshkruajnë zyrtaret të cilet nuk kanë pasur kompetencë te nënshkruajnë lejimin e mjeteve financiare, siç eshte rasti i zyrtares E. Sh., e cila siç ka deshmuar gjate shqyrtimit gjyqesor nuk ka qene ne dijeni per projektin qe eshtë duke nenshkruar. Ndersa lidhur me pretendimin se nuk ka pasur obligim ligjor me formu borde apo keshilla per vleresim të projekteve filmike, gjykata vlereson si te bazuar, pasi që me miratimin e Ligjit per Kinematografinë, ka qene ne kompetencen e QKK vleresimi dhe vendosja per perkrahjen e projekteve filmike. Prandaj i akuzuari B. ka shmangur QKK që në vitin 2008 veç

ishite funksional, kishte drejtorin Z. H., kishte Këshillin Drejtues dhe buxhetin të cilin siç thotë vet ministri B. i kishte ndarë shumë prej 400 mijë euro diku në gjysmën e dytë të vitit. Po ashtu pretendimin se me asnje prove relevante nuk është vertetuar se i akuzuari B. ka tejkaluar autorizimet e veta dhe nuk ka pasur për qëllim përfitimin të ndonjë dobie për kompanin M. F., gjykata e ka gjetur të pabazuar, pasi që siç është vertetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, i njëjti i ka tejkaluar autorizimet, kur ka nënshkruar aneks-kontraten, edhe pse e ka ditur se nuk ka autorizime për këtë, meqë ka anashkaluar QKK, edhe sikur të mos ishte në funksion QKK, atëherë sërish ka anashkaluar Departamentin e Kulturës dhe me këtë, i ka siguruar përfitime të kundërligjshme kompanisë filmike “M. F.”, në shumë prej 100 mijë euro, ndërsa pohimi se deri të nënshkrimi i aneks-kontrates ka ardhur edhe pse Ligji për Kinematografinë është miratuar, QKK nuk ka qenë funksionale, bie në kundërshtim me vet pretendimin e të akuzuarit B. se, nënshkrimi i aneks-kontrates “është detyrimi i tij si ministër [...] për implementimin e një kontrate të ligjshme”.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit **A. M.**, mirepo të njëjten e vlerëson pjesërisht të pabazuar, pasi që lidhur me pretendimin se paratë janë marrë për realizimin e filmit, respektivisht për fazën e parë që është faza përgatitore apo ajo e paproduksionit dhe se ka një ngatrim në nocionin “realizim i një filmi” dhe “gjirimi i një filmi”, gjykata e vlerëson si tendencioze. I saktë është pohimi siç rezulton nga nenin 10 i aneks-kontrates, në të cilën përmendet “[...] M. F. obligohet për zhvillimin dhe prodhimin e filmit “Mysafir në sofër”, duke mos specifikuar mëtej në këtë drejtim, mirepo nëse i referohemi Ligjit për Kinematografinë përkatesisht nenin 42 parashihet se “Shuma e subvencionimit realizohet në tri faza : 1/3 me rastin e xhirimit të kuadrit të parë, 1/3 mbasi të kenë kaluar 30 ditë xhirimi dhe 1/3 kur përfundon xhirimi i kuadrit të fundit”. Në këtë kusht gjykata vlerëson se akuzuari A. ka qenë i obliguar që nga shuma në vlerë prej 100 mijë euro, të realizojë se paku ghirimin e kuderit të parë në përputhje me nenin 42 të Ligjit për Kinematografinë të referuar më lartë. Mirepo i njëjti përveç se nuk ka realizuar këtë, po ashtu nuk ka paraqitur raporte të detajzuara financiare dhe narrative lidhur me realizimin e projektit. Po ashtu pretendimin e mbrojtjes se vepra penale mashtrimi në detyrë mund të kryhet vetëm nga personi zyrtar, dhe se këtë element qenesor nuk e përmbush A. i pasi që ai nuk ka ushtruar autoritet publik apo detyrë të posaçme, mirpo gjykata këtë pretendim e gjenë të pabazuar dhe e shpjegon më vonë tek vlerësimi i ligjor i veprimeve të këtyre dy të akuzuarve.

Gjykata gjithashtu ka analizuar dhe vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit **F. F.**, mirepo të njëjtën e vlerëson pjesërisht të pabazuar dhe me qëllim të shmangies së përgjegjesisë penale, meqë pretendimet se vonesat në realizimin e projektit filmik janë rrjedhojë e vdekjes së njerit nga ko-producentet dhe largimit të producentit tjetër do duhej të adresohen sërish dhe në formë të shkruar në MKRS prej nga edhe i ka marrur paratë, e jo siç thotë me takime të drejtpërdrejta ka njoftuar ministrin. Edhe po ta marrim këtë pretendim si të mireqenë, perseri gjykata nuk e vlerëson se është arsye, meqë me Ujdinë gjyqësore të arritur me datë 18.01.2010 i akuzuari F. si pronar i kompanisë “C. P.” ka marrur obligimin për kthimin e shumës prej 188 mijë eurove deri me datë 01.03.2011 dhe jo siç pretendon i akuzuari se të njëjti i është lënë mundësia e realizimit të projektit filmik, dhe në rast se kjo nuk ndodh atëherë mjetet kthehen. Vetë fakti që i njëjti ka pranuar kthimin e mjeteve në gjithë shumën e marrur prej 188 mijë euro, tregon se i njëjti nuk ka realizuar projektin filmik dhe as që ka filluar realizimin e tij, ndërsa pranë MKRS ka paraqitur të dhëna kinse të njëjta janë shpenzimet në funksion të realizimit të projektit filmik “Power cuts”. Po

ashtu me vone ne kushtet e obligimit per te kthyer shumen e lartreferuar, ai pretendon se ka realizuar projektin me titull pune "Power cuts", me emer te ndryshuar "Në kërkim të Larës". Edhe perkundër obligimit te percaktuar me nenin 13 te kontrates te 27.02.2006, per fillmin e gjirimit te filmit brenda pesë muajve, gjykata nuk ka administruar ndonje shkrese ne cilesin e proves, permes te ciles do provohej se i akzuar F. ka njoftuar MKRS për pamundesin e fillimit te gjirimit te filmit si rrrjedhojë e vdekjes se njerit nga coproducetet, po ashtu i njejt nuk ka njoftuar MKRSe per ndrrimin e emrit te projektit filmik nga "Power cuts" në "Në kerkim të Larës".

- Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akuzuarve A. H. dhe V. B.

Gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve A. H. dhe V. B. janë konsumuar elementet qenësore të figurës së veprës penale që u vihet në barrë, ka vërtetuar se të akuzuarit A. H. dhe V. B., kanë qenë persona zyrtar, respektivisht Ministra të MKRS, kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, duke tejkaluar autorizmet e tyre, ashtu që kanë ndërmarrë veprime zyrtare pa pëlqimin e personit tjetër, apo që ishin në kompetencë të personit tjetër, e që në rastin e projekteve filmike të metrazhit të gjatë ishte i domosdoshëm vlerësimi zyrtar i njerëzve profesionistë të fushës së filmit, përkatësisht të QKK siç përcaktohet me Ligjin per Kinematografinë. Të njëjtit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për tjetrin, përkatësisht për kompaninë filmike "M. F.", pa shpallur fare konkurs për projekte filmike, e në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht me Ligjin për Kinematografinë (2004-22) dhe Ligjin mbi Prokurorimin Publik (2004/17), kanë lidhur kontratë/aneks kontratë me pronarin e kompanisë së përmendur A. M., për subvencionimin e filmit të metrazhit të gjatë "Mysafir në Sofër", në shumë prej 350 mijë euro, nga e cila shumë sipas aneks kontratës veç është paguar kësti i parë në shumë prej 100 mijë euro. Të njëjtit kanë ndërmarrë veprimet të cilat nuk duhej të kryheshin prej tyre në ushtrim të rregullt të detyrës zyrtare, fakt ky që përbënë anën objektive të kësaj vepre penale. Kontrata e nënshkruar nga ministri H., nuk është protokoluuar fare ne arkivin e ministrisë, ndërsa aneks kontrata e nënshkruar nga ministri B. është protokoluuar në kabinetin e ministrit, por paraprakisht nuk është publikuar kurfarë shpallje për film të metrazhit të gjatë, ndërsa projekti "Mysafir në sofër" nuk është vlerësuar fare nga çfarëdo lloj bordi profesional. Edhe para nenshkrimit te kontartes së datës 31.01.2007, ministri H., i kishte premtuar mbeshteje kompanisë "M. F.", ani pse me rastin e nenshkimit te kontrates, producenti A. M. kishte paraqitur vetem nje sinopsis një faqësh, ne mungesë te skenarit apo ndonje garancie financiare qe bene te besueshme realizimin e projektit filmik "Mysafir ne sofer", apo kritereve tjera te specifikuar ne nenin 34 te Ligjit per Kinematografinë. Për këtë kontratë, nga zyrtarët e Departamentit të Kulturës, përkatësisht nga K. B. e K. G., i akzuar H. kishte marë rekomandim për mos procedim të kontratës për shkak të parregullsive, andaj i njëjti për këtë arsye e duke parë edhe parregullsi të tjera gjatë mbylljes së avanseve të dhëna paraprakisht për A. M., ka stagnuar çështjen e pagesës sipas kontratës, por me asnjë veprim nuk e ka anuluar kontratën. Pra çështja e parregullsive paraqitet si arsye që ministri H. ka stagnuar zbatimin e kontratës e jo mungesa e buxhetit, përndryshe nuk do ta nënshkruante kontratën në të cilën kishte paraparë pagesën e këstit të parë të njëjtën ditë. Ky fakt arsyetohet edhe nga deklarimi i të akuzuarit A. M. kur i njëjti në prokurori ka deklaruar se pas lidhjes së kontratës së datës 30.01.2007 "së shpejti ishte njoftuar nga MKRS se kontrata nuk është valide, ngase nuk është respektuar procedura për nënshkrime".

Ligji per kinematografinë ka percaktuar ne nenin 21, se MKRS percakton objektivat e zhvillimit të kinematografisë, ndersa neni 25 par.2 parasheh që QKK, si institucion ka në kompetencë vlerësimin e vendimmarrjes për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kinematografike në funksion të objektivave të politikës së zhvillimit dhe të interesit publik. Me tutje ne nenin 33 eshte parapare se Këshilli Drejtues si ogani kyesor i QKK, shpall konkurs për projekte filmike, ndersa me nenin 37 parashihet që Këshilli Drejtues miraton dhe subvencionon projekte filmike (duke percaktuar edhe kuotën e subvencionit) në bazë të përzgjedhjes nga juria vlerësuese dhe nga raportit i komisionit financiar. Sa i perkete Ligjit per Prokurim Publik nr.2003/17, neni 2, parasheh qe ky ligj vlenë për të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoriteteve kontraktuese dhe koncesionerëve të punëve, ashtu siç percaktohen këto terme në këtë ligj. Ndersa sipas nenit 4 me autoritet kontraktues “nënkupton autoritetin publik [...]”, ndërsa në të njëjtin nen, me “Fonde publike nënkupton (i) para ose mjete financiare që administrohen ose kontrollohen nga autoriteti publik [...] të gjitha paratë ose mjetet financiare të dhëna ose të përvetësuara, drejtpërdrejt ose tërthorazi autoritetit kontraktues ose ndërmarrjes nën Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose nën Fondin e Konsoliduar të Kosovës”. Po ashtu neni 3 parasheh rastet perjashtimore te mos zbatimit te ketij ligji, siç edhe jane pershkruar saktë ne shkresen e datës 16.02.2012 te Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, të aprovuar nga kryesuesi i KRRPP, përkatësisht nga eksperti i fushës së prokurimit publik I. D., te administruar në cilesin e proves ne kete shqyrtim gjyqesor, edhe pse i referohet Ligjit per prokurim publik të mëvonshëm nr.04/L-042, dispozita referuese eshte identike, prandaj edhe është i vlefshem.

Po ashtu ne kushte te njejta ka vepruar edhe i akuzuari V. B. kur ka lidhur aneks-kontraten me “M. F.”, duke tejkualuar autorizimet e tij, ani pse si u referua me lartë, nuk ka pasur autorizime per lidhjen e aneks-kontrates, nga gjendja e vertetuar faktike, eshte e qartë se edhe i akuzuari V. B. ne momentin e nenshkrimit aneks-kontrates, kur edhe mëpas ka transferuar shumen prej 100.000 euro, ka qenë në dijeni për parregullsitë ekzistuese lidhur me zbatimin e kontratës paraprake, ka patur në dispozicion shkresën e zyrtares K. B., dhe për më tepër e ka ditur se kompania filmike “M. F.”, ne kushte te atehershme edhe pse ka paraqitur një skenar të projektit filmik “Mysafir ne sofer”, mirepo jo edhe te dhenen per burimet tjera financiare ku do mbeshtetshin realizimin e ketij projekti filmik. Eshte e rendesishme te referohet fakti se nga momenti i nenshkrimit te kontrates se dt.30.01.2007 e deri te nenshkrimi i aneks-kontrates me dt.19.09.2008, perfshihet periudha kohore prej rreth 20 muaj, dhe perseri kompania filmike “M. F.” me rastin e nenshkrimit te aneks-kontartes nuk ka paraqitur ndonje burim financiar si mbeshtetes të projektit te vet filmik, edhe pse siç thekesohet nga i akuzuari B. ne procesverbalin e marrjes ne pyetje ne prokurori me datë 28.02.2012. faq.3, planifikimi financiar i kosos per realizimin e projektit filmik “Mysafiri ne sofër” ka përfshi shumën rreth 5 milion euro. Por siç ka thekesuar i akuzuari A. M. ne procesverbalin e marrjes ne pyetje ne prokurori me datë 19.12.2012. faq.3 deri te nënshkrimi i aneks-kontartes ka ardhur “si rrjedhoj e ketyre lobimeve ka dale aneks-kontrata [...]”. Pra ministri B.,ka qenë në dijeni se A. M. e ka te pamundur realizimin e projektit filmik te pretenduar, pasi e njejta nuk kishte siguruar asnje mbeshtetje tjeter financiare qe do i mundesonte realizimin e ketij projekti, siç rezulton edhe nga pohimi i te akuzuarit A. M., në procesverbalin e marrjes ne pyetje ne prokurori me datë 19.11.2011. faq.3, kur ka deklaruar se “Ne mungesë te parave une nuk kisha mundesi te filloj projektin...”. Po ashtu duhet te i referohemi faktit se në kohën kur i akuzuari V. B. ka lidhur aneks kontratën, veç ishte tërësisht funksionale QKK me drejtorin Z. H.,

me Këshillin Drejtues e me buxhet të ndarë, siç e konfirmon i njëjti kur deklaron se “në gjysmën e dytë të vitit 2008 kam ndarë buxhetin për QKK në shumë prej 400 mijë euro”. Pretendimin e të akuzuarit V., se sipas nenit 30 të Ligjit 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka pasur të drejtë të bartë mjetet financiare të MKRS prej një vije buxhetore në tjetrën, “neni 30.1 Një organizatë buxhetore mundet, pa marrjen e miratimit paraprak nga Ministri, të transferojë deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal”; gjykata e konsideroi si jolëndore ngase nuk disponon me shifra përkatës buxhetor, por u mjaftua me përkufizimin ligjor nga neni 17 i të njëjtit ligj lidhur me shpenzimet e parasë publike “17.1 Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike. 17.2 Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji”.

Mungesa e skenarit, e një përshkrimi të shkurtër të veprimtarisë që ka zhvilluar si producent dhe si bashkëproducent, si dhe përshkrimin për secilin bashkëproducent të projektit filmik; e elaboratit për realizimin e projektit filmik; e emrave të koautorëve të parashikuar për realizimin e veprës filmike, paraqitja për secilin edhe të dhënat për nivelin e arsimit profesional, për përvojën profesionale dhe për veprat në realizimin e të cilave kanë kontribuar si koautorë (“CV”), kushte keto elementare për realizimin e një projekti filmik siç janë percaktuar në nenin 34 të Ligjit për Kinematografinë, të nevojshme për të krijuar seriozitetin e nevojshëm të paraqitesit të projektit, që në këtë rast është “M. F.”, gjykata vlerëson se janë kritere që japin arsye për të besuar se të akuzuarit A. H. e V. B. e kanë ditur se projekti filmik “Mysafir në sofer” nuk do realizohej dhe në të njëjtën kohë kanë dashur që perkunder kësaj gjendje faktike të vertetuar, të lidhin kontaktë/aneks kontratë që në llogarin e kompanisë filmike “M. F.” të transferojnë shumën prej 350 mijë euro, përkatësisht ministri B. ka transferuar shumën prej 100 mijë euro.

Gjykata vlerëson se të akuzuarit A. H. e V. B., me dashje direkte kanë siguruar të akuzuarit A. M. përfitime të kundërligjshme në dëm të buxhetit të MKRS, përkatësisht të dy alternativat, edhe përfitimi edhe dëmi i shkaktuar janë evidente. Dëmi tanimë është konfirmuar fillimisht nga Raporti i Auditimit, nga përfaqësuesi i MKRS bazuar në faktin se Gjykata Ekonomike e ka aprovuar Kërkesën e MKRS për kompensim të dëmit, për kompaninë filmike “M. F.”, ka nxjerrë një Aktgjykim, i cili është bërë i plotfuqishëm, tani në procedurë të ekzekutimit është refuzuar edhe Prapsimi i ushtruar nga kompania “M. F.”. Për më tepër përgjegjësia subjektive e të akuzuarve, në kushtet e dashjes se drejteperdrejtë me qëllim përfitimi për vete apo për persona të tjerë, është vertetuar edhe nga deklarata e gjithë të akuzuarve kur pohojnë se kanë pasur takime personale producentët me ministrat.

Poashtu të akuzuarit duke qenë se kanë vepruar si persona zyrtar në cilësinë e ministarve, të njëjtit kanë keqpërdorur paratë publike, nën kujdesin e cilëve kanë qenë si rezultat i detyrës publike apo punës së tyre zyrtare, andaj gjykata mbi bazën e arsyesimit të dhënë nga të akuzuarit A. H. e V. B., gjithashtu duke i shikuar në ndërlidhje edhe me provat tjera, konstaton se pretendimeve të tyre nuk duhet falë besimin.

- **Vlerësimi ligjor i veprimeve të t'akuzuarve F. F. dhe A. M.**

Gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve F. F. dhe A. M. janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale mashtrimi në detyrë nga neni 341, par 3 lidhur me par.1 të KPK, sipas të cilit kod mashtrimi në detyrë përfshinë “Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bën prezentimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme”, ndërsa si formë e kualifikuar është nëse vepra penale me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro.

Lidhur me cilësinë e personit zyrtar, e cila nga të akuzuarit është referuar se ata nuk e kanë pasur këtë cilësi, se është i gabuar ky kualifikim juridik, gjykata vlerëson me të drejtë se ky konstatim nuk qëndron, sepse sipas nenit 107 par.1 nënpar.2 të KPK, person zyrtar përveç tjerash është edhe “Personi i autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik [...]”, ndërsa nga provat e administruara gjegjesisht nga Çertifikatat e Biznesit të leshuara nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, rezultojnë se Produkcioni “M. F.” është i regjistruar si biznes individual me pronar A. M., ndërsa “C. P.” Sh.p.k. është e regjistruar në cilësinë si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me pronar F. F.. Sipas Ligjit për Shoqëri Tregtare, person i autorizuar” ka kuptimin për ndermarrjet individuale siç përcaktohet në nenin 13 par 4 pika c “personi i cili është pronar i ndermarrjes në fjalë”, ndërsa sipas nenit 13 par 4 pika i, lidhur me nenin 2 të Ligjit për Shoqërit Tregtare person i autorizuar i kompanive është njëri nga themeluesit e kompanisë.

Nga provat e administruara është vërtetuar se të akuzuarit kanë prezantuar dëshmi të rreme për të arsyetuar qëllimin e marrjes së subvencionit dhe për të arsyetuar shpenzimet për destinimin e pretenduar, përkatësisht kanë bërë prezentim të rremë të raportit të llogarive duke pretenduar se shpenzimet janë bërë në funksion të realizimit të projektit filmik “Power cuts” gjegjesisht në funksion të realizimit të fazës së paraprodhimit të filmit “Mysafir në sofër”. Siç edhe është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes provave të administruara, natyra e shpenzimeve nga të akuzuarit, por edhe mungesa e çfarëdo produkti nëse vërtete shpenzimet do ishin bërë në realizimin e projekteve filmike, provojnë natyrën e rreme të raporteve të paraqitura. Duke ju referuar në veçanti të akuzuarit F. F., i njëjti meqë pas prezentimit të rremë të të dhënave, është obliguar për kthimin e gjithë shumës së marur nga MKRS për realizimin e projektit filmik “Power cuts”, duke u munduar ta vejë në lajthim personin zyrtar të MKRS, ka paraqitur si të realizuar projektin filmik, edhe pse në të vërtetë fjala është për një projekt tjetër filmik të titulluar “Ne kerkim të Lares”. Është e qartë dhe e natyrshme që i njëjti pas obligimit për kthimin e mjeteve të marura për realizimin e projektit filmik “Power cuts” dhe në kushtet e pamundësisë për kthimin të tyre, pretendon se filmin e ka realizuar, me përjashtim të titullit të filmit që tanimë quhet “Ne kerkim të Lares”, me arsyetimin se i pershtatet me mirë përmbajtjes së tij. Siç thuhet në njoftimin e dt. 02.07.2012 gjirimet kanë filluar në fund të vitit 2010, pa referuar një datë të saktë të fillimit të tyre, mirepo është afër një vit pas Ujdisë gjyqësore të arritur me datë 18.01.2010 për kthimin e mjeteve që e ka pasur të kufizuar në kohë, përkatësisht deri me datë 01.03.2011. Po ashtu, nga lidhja e kontratës me 27.02.2006 e deri në fund të vitit 2010 siç pohon edhe vete i akuzuari F., nuk kishte filluar gjirimin e projektit filmik, pra në një periudhë katër vjeqare, edhe pse sipas

nenit 13 te kontrates se lartcekur, gjirimi i filmit duhej te fillonte brenda pesë muajsh. Nëse gjirimin e filmit i akuzuari F. e ka filluar nga fundi vitit 2010, atëherë shtrohet pyetja, si ka pasur mundësi t'a përfundojë dhe t'a dorëzojë në MKRS me datë 10.05.2011, një film të metrazhit të gjatë, si projekt të realizuar siç pretendon i njejti, derisa në shqyrtim gjyqësor thekson se realizimi i një filmi zgjatë me vite e vite.

Gjithashtu i akuzuari A. M. duke mos perfillur kushtet e aneks kontrates beri shpenzimin e ketyre mjeteve të marura perkunder afateve te parapara dhe destinimeve te caktuara, ne kete menyre pas kerkeses së MKRS paraqiti një llogari të rreme për shpenzimet per gjirimin e filmit “Mysafir ne sofer” i cili në fakt asnjehere nuk u realizua. Siç edhe eshte vertetuar gjate shqyrtimit gjyqësor permes provave te administruara, natyra e shpenzimeve nga i akuzuari M., por edhe mungesa e çfarëdo produkti nese vertete shpenzimet do ishin bere ne realizimin e projektit filmik, provojnë natyren e rreme te raporteve te paraqitura. Nga provat e administruara, eshte vertetuar se edhe pse ka pretenduar duke paraqitur te dhena pranë MKRS, i njejti nuk ka arritur te arsyetojë shumën prej 15.000 euro, ndersa nga shpenzimet per pjesen tjeter te paraqitur, vertetohet se te njejtat nuk i ka shpenzuar lidhur me projektin filmik “Mysafir ne sofer”, por duke qene ne kushtet e obligimit per kthimin e mjeteve të marura, i njejti ka dorezuar një seri te dhenash ne funksion te pretendimit per rezultatet e dalura nga mjetet e shpenzuara. Keshtu pergjate vitit 2010 ka nënshkruar nje seri parakontratash-Shprehje e interesit nga producentët e “Mysafir ne sofër”, me aktoret N. Xh. date 16.08.2010; L. Xh. dt.16.08.2010; P. H. S.C.S dt.25.04.2011; D. D. dt. 22.09.2010; D. H. dt.16.08.2010, per te luajtur kinse ne projektin filmik “Mysafir ne sofer”. Po ashtu nëse i referohemi Ekspertizës së dt.24.10.2011 e punuar nga ekspertet: per kinematografinë A. S. dhe per financa nga Sh. B., te angazhuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut ne Prishtine, te cilën gjykata e ka administruar ne cilësinë e provës te paraqitur nga i akuzuari A. M., ne faq. 5 konstatohet se konstrukcioni financiar i M. F. përfshinë shumen prej 750 mijë euro, nga te cilat burime te mjeteve nga MKRS ishin ne shume prej 350 mijë euro dhe burime të mjeteve nga “M. F.”, ishin ne shume prej 400 mijë euro, gjykata vlerëson nëse shuma totale e projektuar per projektin filmik “Mysafir ne sofër” përfshin shumen prej 750 mijë euro, atëherë si eshte e mundur qe 20% e mjeteve te shpenzohen ne fazën e ashtuquajtur “paraproduksionit”, e që natyra e shpenzimeve në këtë fazë konsiston në pagesa në avans, akomodime, benzin, telefon etj.

- Vlerësimi i provave shfajesuese

Gjykata ka vleresuar provat e paraqitura nga i akuzuari A. M., si janë librat 2.3.4-Raportet financiare te vitit 2008, 2009, 2010 per projektin filmik “Mysafir ne sofer”; libri nr 5-libri i lokacioneve te gjirimeve, libri nr 6-skenari i projektit filmik “Mysafir ne sofer”, libri nr 7-drafti i regjisorit per “Mysafir ne sofer”, libri nr.8-libri i punës per drejtorin e filmit, skenografin, kostumografin, regjisorin, rekuizitorin etj, libri nr 9-Lista e karaktereve dhe specifikacioni i skenave; libri nr.10-data baza e aktoreve kosovare, libri nr. 11-album fotografish nga lufat gjate viteve 1998-1999 ne Kosove; libri nr.12-ekipi të filmit gjate punëve para-pregatitore; libri nr 13-13a- Draft buxheti per “Mysafir ne sofer”; libri nr 15 -Foto te produksionit, M. F., gjate gjirimit te projektit “Gjakova 726”; Ekspertiza e dt. 24.10.2011 e punuar nga ekspertet: per kinematografin A. S., per financa Sh. B., te angazhuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut ne Prishtine; Shkresa-shpjegim i dt. 11.03.2012 nga regjisorin I. Q.; mirepo te njejtave nuk u ka fal besimin, meqenese

nga vleresimi i brendisë dhe nga permbajtja e veçantë e seciles prej tyre, rezulton se nje pjese e tyre paraqet kopje nga shkresat e lëndës, ndërsa një pjesë është e perbere nga fotografi qe veshtirë kuptohet pse jane aty dhe cili është qellim i atyre qe jane ne to, me perjashtim te fotografive nga periudha e luftes apo fotot që siq thuhet per gjirimin e projektit “Gjakova 726”. Po ashtu nuk eshte kontestuese se arti eshte veprimtari e shtrenjtë, siq konstatohet nga I. Q. ne shkresen e dt.11.03.2011, mirepo gjyka vlereson se kjo dhe provat tjera te paraqitura nga i akuzuari A. M., nuk sjellin njoftime relevante ne kete ceshtje juridiko-penale, dhe si te tilla nuk ndikuan ne vertetimin e nje gjendje tjetër faktike, nga gjendja faktike e vertetuar ne gjithe shqyrtimin gjyqësor nga provat e administruara, te cilave gjykata ua fali besimin pasi qe bindshëm u vërtetua se i akuzuari A. M. ka kryer veprën penale per te cilën akuzohet.

Po ashtu gjykata vlerësoi provat e paraqitura nga i akuzuari F. F., siç janë vërtetimi i datës 26.06.2012 mbi pranimin e pagesës ne vlerë prej 250 euro per shfaqjen e filmit “Finding Lara- Në kerkim te Lares”, KDSHF G. me datë 02.07.2012 ne ora 18:00; ftesa e derguar nga kompania “C. P.”, per shfaqjen e filmit “Ne kerkim te Lares-finding Lara”, ne kino A. me 2 korrik 2012, nga ora 17:30-18:00, kopja e njoftmit te dt. 10.05.2011, me te cilen njoftohet MKRS se projekti filmik ka perfunduar; Komunikaten per media per shfaqjen e premieres se filmit “Ne kerkim te Lares” e dt. 02.07.2012, mirepo te njejtat nuk ndikuan ne vertetimin e nje gjendje tjetër faktike, gjegjesisht ne pergjegjesin penale te të akuzuarit F. F., pasi që edhe nga vete provat e paraqitura nga i akuzuari F., vertetohet fakti që kemi te bejme me nje projekt tjetër filmik, te ndryshem nga projekti filmik “Power cuts” per realizimin e te cilit kompania “C. P.” ka marur shumen 188 mijë euro, ndërsa nuk ekziston asnjë shkresë që dëshmon se është arritur farë pajtimi midis nënshkruesish të kontratës për ndryshimin e filmit që ishte objekt i kontratës. Kështu që nga kopja e njoftmit te dt. 10.05.2011, rezulton se njoftohet MKRS se projekti filmik ka perfunduar, me çka pretendohet edhe dorezimi i kopjes se pare te projektit filmik, i cili siç thuhet zgjat 1.40 min, mirepo ne te njejtën kohe ne njoftim theksohet se i njejtë eshte i paperkthyer ne gjuhen shqipe, ndersa korrektimi final i ngjyrave eshte duke u kryer ne Angli, me çka rezulton se nuk ka mundur te thirret ne perfundim te projektit siq pretendon. Ndersa komunikata per media per shfaqjen e premieres se filmit “Ne kerkim te Lares” e dt. 02.07.2012, eshte nje faqëshe dhe nuk permban asnje nenshkrim ose vulë apo emer, në permbajtjen e te njejetes eshte e shenuar se filmi eshte komedi avanturë romantike dhe se gjirimet filluan ne fund te vitit 2010. Gjykata vlereson se nga keto shkresa te administruara ne cilesin e proves, vertetohet fakti se nuk eshte realizuar dhe as shfaqur projekti filmik “Power cuts”, e nëse është shfaqur në vitin 2012 projekti filmik “Në kerkim te Lares” atëherë eshte shfaqur një film tjetër për të cilin gjykata nuk ka asnjë provë që vërteton se bëhet fjalë për projektin e njëjtë filmik të kontraktuar, fakt ky që eshte pranuar edhe nga i akuzuari, edhe pse ndryshe nga gjendja faktike e vertetuar, i njëjtë ka pohuar se ndryshimi eshte vetem ne titullin e filmit, mirepo jo edhe ne permbajtjen e tij.

Mbi bazën e arsyetimit të dhënë, gjithashtu duke i shiquar në ndërlidhje edhe me provat tjera, gjykata konstaton se pretendimeve kësisoji të t’akuzuarve A. M. e F. F. nuk duhet falë besimin e plotë.

Me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që përcaktojnë llojin dhe lartësisë e dënimit për secilin të akuzuar, si rrethana lehtësuese

për katër të akuzuarit pati faktin se janë familjar, faktin se nuk kanë qenë më parë të gjykuar, sjelljen e tyre korrekte në gjykatë, si dhe kohën nga kur është kryer vepra penale. Ndërsa për te akuzuarit A. M. dhe F. F., gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 44 par.1 të KPK, i cili parasheh që në kushtet e zbatimit të dispozitave të zbutjes së dënimit, kryesisht mund t'i shqiptohet dënim me kusht për veprën penale për të cilën është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata gjeti se ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, meqë nisur nga sjellja e me parshme e të njejtëve, të cilët nuk kanë qenë më parë të hetuar në cilësinë e të dyshuarëve apo të denuar për kryerjen e ndonjë veprë penale, dhe po ashtu sjellja e mëvonshme e tyre pas kryerjes së veprës penale, duke pasur parasysh se nga viti 2006/2007 nuk është evidentuar se të njëjtit janë përfshirë në çfarë do mënyrë në ndonjë veprë tjetër penale, janë rrethana të cilat tregojnë se të njëjtit nuk janë delikuent të rrezikshëm. Andaj gjykata vlereson se nën dritën e qëllimit të dënimit siç është përcaktuar në nenin 41 të KPRK, është të parandalohet kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, andaj ka formuar bindjen se të njëjtit në të ardhmen nuk do të kryejnë veprë penale dhe se në pajtim me parimin e legjitimitetit të sanksioneve penale i cili konsiston në faktin se ndaj kryerësve të veprave penale duhet të shqiptohen vetëm ato lloje të dënimeve të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe arritjen e përmirësimit dhe të resocializimit, e në rastin konkret dënimi i paraparë është shumë i rrept, kurse dënimi i shqiptuar si në dispozitiv për te akuzuarit është adekuat, i drejtë, andaj gjykata ua shqiptoi me bindje se të njëjtit në të ardhmen nuk do të përsërisin veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.362/16, me datë 15.12.2016**

**Sekretarja juridike,
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.